



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 152

Tiranë – E premte, 12 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50, datë 26.7.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 45, 50, 56 dhe 63 të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.....	11747
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51, datë 26.7.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 836, datë 6.2.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.....	11752
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 26.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 13 dhe 14 të Kodit të Procedurës Penale, sipas interpretimit të bërë me vendimin unifikues nr. 2, datë 20.6.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	11756
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 53, datë 26.7.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 157, datë 14.5.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë, brenda një afati të arsyeshëm. Detyrimin e subjektit të interesuar të marrë masa për ekzekutimin e detyrimit të përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë së bashku me shpenzimet procedurale në shumën totale prej 727.708 lekësh.....	11760
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 54, datë 27.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 463, datë 16.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 357, datë 23.10.2013 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2015-938, datë 21.5.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	11764

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 27.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të paragrafit 3, të nenit 5, të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, datë 30.5.2013.....	11767
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 27.7.2016	Me objekt shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të paragrafit 3, të nenit 62, të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.....	11774
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 57, datë 29.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të shkronjës “ç”, pika 2, të nenit 33, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.....	11788

**VENDIM****Nr. 50, datë 26.7.2016****NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Vladimir Kristo anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.6.2016
mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë
dokumentesh, çështjen nr. 34 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Sindikata e Punonjësve të
Policisë së Shtetit

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Gjykata
Administrative e Apelit,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i
Ministrave,

Ministria e Punëve të Brendshme.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës
për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e
mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i
neneve 45, 50, 56 dhe 63 të ligjit nr. 49, datë
3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e
gjykatave administrative dhe gjykimin e
mosmarrëveshjeve administrative”.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 50, 55/1, 55/2,
59/1/c, 100, 116, 118, 131/f dhe 134/1/g të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr.
8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe
funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës
së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës
Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ);
Deklarata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut;
Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës
e Gjenevës nr. 155, datë 3.6.1981; Karta Sociale
Evropiane e të Drejtave.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo,
mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të
kërkuesit, që është shprehur për pranimin e
kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të

interesuara, Këshilli i Ministrave, Kuvendi i
Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të
Brendshme, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si
dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I**

1. Kërkuesja është organizatë sindikale e
themeluar sipas legjislacionit në fuqi, e cila ka për
qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të
ligjshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit.

2. Në datën 23.12.2015 kërkuesja i është drejtuar
Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me
kërkesëpadi me objekt detyrimin e Këshillit të
Ministrave të nxjerrë aktet normative për zbatim të
neneve 61/1, 67, 68/4, 69/3, 70/2, 71, 72/2,
75/1/ç, 75/2 dhe 81/2 të ligjit nr. 108, datë
31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit”, si dhe detyrimin
e palës së paditur t’i shpërblejë dëmin moral
paditësit në shumën 1 (një) lek.

3. Për sigurimin e padisë kërkuesja ka paraqitur
po në të njëjtën datë kërkesë për sigurim padie me
objekt pezullimin e ligjit nr. 108, datë 31.7.2014,
“Për Policinë e Shtetit”, dhënien fuqi të ligjit nr.
9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” dhe
vendosjen e masës së sekuestros në fondin e palës
së paditur për shumën 1 (një) lek deri në
përfundimin e gjykimit të çështjes së lartpër-
mendur.

4. Kërkuesja parashtron se deri në datën e
paraqitjes së kërkesës përpara kësaj Gjykate
(22.1.2016) kërkesëpadi dhe kërkesa për pezullim
nuk janë hedhur akoma në short dhe se nuk ka
asnjë informacion lidhur me këto dy akte
procedurale.

5. Lidhur me objektin e dytë të kërkesës,
shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të
neneve 45, 50, 56 dhe 63 të ligjit nr. 49, datë
3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e
gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrë-
veshjeve administrative” (ligji nr. 49/2012),
rezulton se Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin
nr. 49/2012 me objekt përcaktimin e rregullave të
detyrueshme për organizimin dhe funksionimin e
gjykatave administrative, si dhe statusin e gjyqtarëve
që shërbejnë në to; juridiksionin dhe kompetencën
e gjykatave administrative; parimet dhe procedurën
e gjykimit, palët në proces dhe personat e tjerë në
gjykimin administrativ; vendimet gjyqësore admi-
nistrative dhe ekzekutimin e tyre (neni 1).



6. Ligji i lartpërmendur është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 53, datë 16.5.2012 dhe ka hyrë në fuqi (sipas nenit 73 të tij) 15 ditë pas këtij botimi, pra në datë 31.5.2012.

7. Pavarësisht se ligji nr. 49/2012 ka hyrë në fuqi në datën 31.5.2012, ai ka filluar të zbatohet vetëm pjesërisht për shkak të kohës së domosdoshme që nevojitej për ngritjen dhe funksionimin efektiv të gjykatave administrative, sipas parashikimeve të shprehura posaçërisht në të.

8. Ligji nr. 49/2012, në kreun X të tij *“Dispozita kalimtare dhe të fundit”*, në pikën 1 dhe 5 të nenit 70 *“Fillimi i funksionimit të gjykatave administrative”* parashikon: *“1. Gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë fillojnë funksionimin e tyre në mënyrë të njëkohshme.” 5. Data e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë”*.

9. Në zbatim të nenit 70/5 të ligjit 49/2012, bazuar në propozimin e ministrit të Drejtësisë, Presidenti i Republikës ka nxjerrë dekretin nr. 8349, datë 14.10.2013, në të cilin ka përcaktuar datën 4.11.2013 si ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative. Kjo datë shënoi dhe fillimin e efekteve të plota juridike dhe zbatimin në tërësi të ligjit nr. 49/2012 lidhur me juridiksionin, kompetencën dhe procedurën e gjykimit të çështjeve që kanë për objekt mosmarrëveshjet administrative të përmendura në nenin 7 të tij.

II

10. *Kërkuesja* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto argumente:

A. Për kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor:

10.1 Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm të parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Kërkuesja pretendon se edhe pse neni 28/3 i ligjit nr. 49/2012 për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë parashikon një afat prej 5 ditësh nga data e paraqitjes në gjykatë, çështja ende nuk është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

B. Për kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 45, 50, 56 dhe 63 të ligjit nr. 49/2012:

10.2 Kërkuesja parashtron se legjitimohet *ratione personae* në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134/1/f dhe neni 49/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”*, si dhe *ratione temporis*, pasi e ka paraqitur kërkesën brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit organik të kësaj Gjykate, duke pasur parasysh se ligji i kundërshtuar ka gjetur zbatim me dekretin nr. 8349, datë 14.10.2013, *“Për fillimin e funksionimit të gjykatave administrative”*. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, përderisa kërkuesja ka për objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të punonjësve të Policisë së Shtetit, ku, ndër të tjera, hyn edhe e drejta për t’iu drejtuar gjykatës për kundërshtimin e akteve që lidhen me marrëdhëniet e punës që rregullohen nga ana e ligjit të kundërshtuar, ekziston lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimtarisë së saj dhe normave të kundërshtuara.

10.3 Nenet 50 dhe 63 të ligjit të kundërshtuar cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës), si dhe të drejtën për t’u dëgjuar (neni 33 i Kushtetutës) sepse parashikojnë të drejtën e gjykatës administrative të apelit dhe Gjykatës së Lartë të gjykojnë në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve.

10.4 Nenet 45 dhe 56 të ligjit cenojnë nenin 43 të Kushtetutës, sepse kufizojnë respektivisht të drejtën e ankimit në gjykatën administrative të apelit dhe të drejtën për rekurs. Në këtë mënyrë këto dispozita cenojnë edhe nenin 135 të Kushtetutës.

10.5 Nenet e kundërshtuara bien ndesh me nenin 6 të KEDNJ-së lidhur me sigurinë juridike, për sa kohë vendimet mund të ndryshohen pa praninë e palëve.

10.6 Nenet e kundërshtuara cenojnë të drejtën e aksesit në gjykatë.

11. *Subjektet e interesuara* kanë prapësuar me shkrim në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

A. Për kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor:

11.1 *Këshilli i Ministrave:*

11.1.1 Kërkuesja duke iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese brenda një kohe shumë të shkurtër nga momenti i depozitimit të kërkesëpadisë ka penguar Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë të vijoje në gjykimin e çështjes.



11.1.2 Detyrimi i Këshillit të Ministrave për të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të ligjit nr. 108/2014 përbën një aspekt formal të procesit dhe jo një kusht që lidhet drejtpërdrejt me realizimin e të drejtave materiale që rrjedhin nga ligji. Për pasojë, mosnxjerrja e aktit nënligjor nga Këshilli i Ministrave nuk pengon kërkuesen të realizojë të drejtat materiale.

11.1.3 Kërkuesja nuk i ka ezauruar të gjitha instancat administrative, pasi në bazë të nenit 30 të ligjit nr. 9000/2003, subjektit që i është cenuar një e drejtë ose një interes i ligjshëm ka të drejtë të ankohet te Kryeministri kundër aktit të ministrit ose të drejtuesit të institucionit qendror në varësi të Kryeministrit, sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative (KPA).

11.2 *Ministria e Punëve të Brendshme.*

11.2.1 Në seancën e datës 18.4.2016 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, lidhur me kërkesën për themelin e çështjes, ia ka dërguar aktet Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës funksionale, duke caktuar si seancë të radhës datën 18.5.2016. Ndërsa në momentin e shqyrtimit të kërkesës për sigurim padie nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, pala kërkuese ka hequr dorë nga kjo kërkesë.

11.2.2 Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2016 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e propozimit për shtimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit” dhe dekretimin e emërimit të tyre nga Presidenti i Republikës në datën 15.3.2016, janë rihedhur në short çështjet e regjistruara në atë gjykatë. Kjo rrethanë ka ndikuar në kohëzgjatjen e procedurave të regjistruara në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

11.2.3 Bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, arsyeshmëria e afatit nuk duhet konsideruar *stricto sensu*, por *lato sensu*. Për pasojë, afati ligjor që i referohet pala kërkuese nuk mund të barazohet me afatin e arsyeshëm.

B. Për kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 45, 50, 56 dhe 63 të ligjit nr. 49/2012:

11.3 *Këshilli i Ministrave.*

11.3.1 Kërkuesja nuk legjitimohet *ratione materiae* për vënien në lëvizje të Gjykatës, sepse nuk ka arritur të provojë një interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak në çështjen konkrete midis

misionit për të cilin është krijuar, veprimtarisë që ajo kryen dhe pasojave që rrjedhin nga nenet 45, 50, 56 dhe 63 të ligjit 49/2012.

11.3.2 Nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 kanë klasifikuar një grup çështjesh, të cilat, për shkak të vlerës së vogël të objekti të padisë, nuk mund të ankimohen në një shkallë më të lartë në respekt të parimit të proporcionalitetit, sikurse ka analizuar edhe vendimi unifikues nr. 3, datë 6.12.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

11.3.3 Kufizimi i së drejtës së ankimit, i parashikuar në nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, është i arsyeshëm dhe në proporcion me interesin publik për të cilin ligjvënësi e ka parashikuar këtë kufizim. Interesi publik i identifikuar ka të bëjë me nevojën e një administrimi sa më të mirë, efektiv dhe efikas të drejtësisë, duke i dhënë zgjidhje sa më të shpejtë mosmarrëveshjeve administrative dhe duke arritur paqen sociale me kosto sa më të ulët për shtetin dhe publikun.

11.3.4 Nenet 50 dhe 63 të ligjit 49/2012, duke parashikuar respektivisht rastet kur Gjykata Administrative e Apelit apo Kolegji Administrativ gjykojnë në dhomë këshillimi, nuk cenojnë asnjë prej elementeve të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

11.4 *Kuvendi i Shqipërisë.*

11.4.1 Nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 kanë vendosur një kufizim të së drejtës së ankimit në respekt të parimit të proporcionalitetit. Qëllimi i ligjvënësit në vendosjen e pragut si kusht për të ushtruar të drejtën e ankimit/të rekursit, ka qenë shmangia e mbingarkesave të gjykimeve të mosmarrëveshjeve administrative me vlerë të vogël padie, duke i dhënë fund gjykimit në shkallë të parë në rastin e nenit 45 dhe në shkallë të dytë në rastin e nenit 56 të ligjit. Ky kufizim mbi të drejtën e ankimit është vendosur duke mbajtur parasysh interesin publik në efektivitetin dhe shpejtësinë e gjykimit administrativ, si dhe vlerën e ulët të objekti të padisë (qëllimi i ligjshëm).

11.4.2 Nenet 45 dhe 56 të ligjit 49/2012 nuk cenojnë të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj (moscenim i thelbit të së drejtës).

11.4.3 Nenet 50 dhe 63 të ligjit 49/2012 duhet të lexohen në unitet me dispozitat e tjera të ligjit,



qëllimi i të cilit është thjeshtimi i procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave. Përparësi në këtë kontekst marrin elementet “dijeni mbi procesin, njoftimi i rregullt i palëve dhe mundësia për t’u shprehur”, të cilat garantohen nga ligji në fjalë. Mungesa e palëve dhe gjykimi mbi bazën e akteve shkresore nuk u heq asnjë mundësi palëve të realizojnë të drejtat e tyre, për më tepër kur atyre u jepet mundësia (sipas nenit 49 të ligjit) të paraqesin deri 5 ditë para seancës parashtrime me shkrim. Kjo veçori i përshtatet funksionit dhe natyrës së gjykimit administrativ të shpejtë dhe efektiv.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

A.1 Për pretendimin për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor

12. Kërkuësja pretendon se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm të parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Sipas kërkuësës, edhe pse neni 28/3 i ligjit nr. 49/2012 për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë të depozituar prej saj parashikon një afat prej 5 ditësh nga data e paraqitjes në gjykatë, çështja ende nuk është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 81, datë 28.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se:

a) nga materialet bashkëlidhur kërkesës, kërkesë-padia si dhe kërkesa për sigurim padie edhe pse i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ato janë depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 23.12.2015. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. 4767/1 prot., datë 12.4.2016, sqaron se kërkesa është marrë në

shqyrtim nga kjo gjykatë në datën 28.12.2015 (brenda afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 28/3 të ligjit 49/2012) dhe se me vendimin nr. 80-2015-4873 ka vendosur moskompetencën e saj dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Apelit si gjykatë kompetente. Në datën 26.2.2016 aktet i janë dërguar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

b) Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me shkresën nr. 847/1 prot., datë 15.4.2016, informon se çështja në fjalë është regjistruar në datën 1.3.2016 dhe seanca është caktuar në datën 18.4.2016. Në këtë seancë Gjykata Administrative e Apelit Tiranë kryesisht, sikurse rezulton nga shkresa nr. 20/1, datë 13.6.2016 e kësaj gjykate, me vendimin e datës 18.4.2016 ia ka dërguar aktet Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për kompetencën funksionale me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

c) nga shkresa nr. 20/1, datë 13.6.2016 e Gjykatës Administrative të Apelit, gjithashtu, vërehet se seanca e radhës është caktuar në datën 15.6.2016 në pritje të vendimit të Gjykatës së Lartë.

15. Bazuar në këto rrethana, Gjykata, nisur nga fakti se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën çështje administrative dhe se Gjykata e Lartë nuk është shprehur akoma për mosmarrëveshjen e kompetencës funksionale ndërmjet tyre, vlerëson se çështja e juridiksionit ndërmjet këtyre gjykatave për shqyrtimin e kërkesë-padisë dhe të kërkesës për sigurim padie të depozituara nga kërkuësja nuk është zgjidhur akoma. Për pasojë, Gjykata nuk mund të shprehet mbi pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

16. Nga sa më lart, Gjykata çmon se kërkuësja nuk legjitimohet *ratione materiae* për t’iu drejtuar kësaj Gjykate.

A.2 Për pretendimin për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 45, 50, 56 dhe 63 të ligjit nr. 49/2012.

17. Çështja e legjitimitimit të kërkuësës (*locus standi*) sipas jurisprudencës kushtetuese përbën kusht procedural për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për kontrollin abstrakt të një norme ligjore (*shih vendimin nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës*



Kushtetuese).

18. Kërkuesja pretendon se legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134/1/f dhe neni 49/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, si dhe *ratione temporis*, pasi e ka paraqitur kërkesën brenda afatit 3 – vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit organik të kësaj Gjykate, duke pasur parasysh se ligji i kundërshtuar ka gjetur zbatim me dekretin nr. 8349, datë 14.10.2013, “Për fillimin e funksionimit të gjykatave administrative”. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, përderisa kërkuesja ka për objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të punonjësve të Policisë së Shtetit, ku, ndër të tjera, hyn edhe e drejta për t’iu drejtuar gjykatës për kundërshtimin e akteve që lidhen me marrëdhëniet e punës që rregullohen nga ana e ligjit të kundërshtuar, sipas saj ekziston lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimtarisë së saj dhe normave të kundërshtuara.

19. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione materiae* për vënien në lëvizje të Gjykatës, sepse nuk ka arritur të provojë një interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak në çështjen konkrete midis misionit për të cilin është krijuar, veprimtarisë që ajo kryen dhe pasojave që rrjedhin nga nenet 45, 50, 56 dhe 63 të ligjit 49/2012.

20. Gjykata vëren se bazuar në nenin 134/1/f të Kushtetutës, organizatat bëjnë pjesë në grupin e dytë të subjekteve që ushtrojnë në mënyrë të kufizuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Për të treguar që ka legjitimitet, subjekti iniciues ka detyrimin të provojë lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet interesit ligjor që ai ka dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimin nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta. Shoqatat duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën. Vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të

rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimin nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesja, Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit, është person juridik i regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3716, datë 17.5.2007. Për pasojë, Gjykata vlerëson se kërkuesja është një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1/f të Kushtetutës, pra legjitimohet *ratione personae* për ta vënë në lëvizje atë për kontrollin abstrakt të ligjit nr. 49/2012.

23. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesja legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa e saj është paraqitur brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit organik të kësaj Gjykate, duke pasur parasysh se ligji i kundërshtuar ka gjetur zbatim me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8349, datë 14.10.2013, “Për fillimin e funksionimit të gjykatave administrative”.

24. Në funksion të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se bazuar në statutin e kërkueses qëllimi i veprimtarisë së kësaj shoqate (neni 7) është nënshkrimi i kontratës kolektive të punës në emër dhe për llogari të anëtarëve të vet; përmirësimi i kushteve të punës dhe të drejtave sociale të anëtarëve; mbrojtja e interesave materiale dhe sociale të anëtarëve; mbrojtja e së drejtës për punë; kualifikimi profesional i anëtarëve; mbrojtja e të drejtave të fituara; përfaqësimi i anëtarëve në raport me të tretë; realizimi i bashkëpunimit, si dhe aderimi në organizata e forume të ngjashme ndërkombëtare; krijimi i fondit të solidaritetit në nivel sindikate; informimi i anëtarëve të sindikatës për çdo veprimtari për punën e bërë. Ndërsa sipas nenit 8 të këtij statuti detyra dhe qëllimi i sindikatës është mbrojtja e të drejtave të punës dhe atyre sociale për anëtarët e saj, çka e realizon me përfaqësimin që u bën, si dhe me ndihmën ligjore që u jep anëtarëve.



25. Nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, objekt kundërshtimi, kanë përcaktuar një kategori çështjesh, të cilat, për shkak të vlerës së vogël të objektit të padisë, nuk mund të ankimohen në një shkallë më të lartë, ndërsa nenet 50 dhe 63 të ligjit 49/2012 parashikojnë respektivisht rastet kur Gjykata Administrative e Apelit apo Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykojnë në dhomë këshillimi.

26. Në argumentet që kërkesja ka paraqitur para kësaj Gjykate për jokushtetutshmërinë e neneve të ligjit të kundërshtuar pretendohet cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i së drejtës për t'u dëgjuar, i së drejtës së ankimit apo i së drejtës për akses në gjykatë. Sikurse u theksua më lart (shih paragrafin nr. 18), kërkesja parashtron se ekziston lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimtarisë së saj dhe normave të kundërshtuara, pasi objekti i veprimtarisë së saj konsiston në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të punonjësve të Policisë së Shtetit, në të cilat hyn edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës për kundërshtimin e akteve që lidhen me marrëdhëniet e punës (pagës) që rregullohen nga ana e ligjit të kundërshtuar.

27. Gjykata vlerëson se edhe pse kërkesja parashtron se çdo anëtar i saj ka një interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak në çështjen konkrete, lidhur me nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, ajo nuk parashtron argumente kushtetuese për cenimin e interesave konkretë të anëtarëve të saj. Nga ana tjetër, nenet 50 dhe 63 të ligjit *de quo* janë norma procedurale, të cilat nuk rregullojnë marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkeses dhe nuk ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e saj.

28. Nga sa më lart, Gjykata, duke e vlerësuar legjitimitimin e Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shteti në vështirim të standardeve kushtetuese, çmon se ky subjekt nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues, për arsye se nuk ka arritur të provojë lidhjen konkrete midis objektit të veprimtarisë së saj dhe dispozitave ligjore që kërkon të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën.

29. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesja nuk ka arritur të justifikojë interesin e saj për të vënë në lëvizje Gjykatën, në kuptim të nenin 134/2 të Kushtetutës. Si përfundim, ajo nuk legjitimohet *ratione materiae* edhe për këtë kërkim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a, 131/f, 134/1/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 51, datë 26.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 2.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 11 Akti që i përket:

KËRKUES: SELAMET BERISHA

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaramit

Zyra Përmbarimore Tiranë, Avokati i Popullit

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 836, datë 6.2.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1/2, 42, 43, 44, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, Selamet Berisha, që kërkoji pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Sipas akteve bashkëlidhur kërkesës rezulton se ndërmjet kërkuarit S.B. dhe shtetasit N.M. është lidhur kontrata e huas me nr. 1617 Rep., dhe nr. 254 kol., datë 4.10.2004, ku kërkuari i ka dhënë shtetasit N.M. një hua në shumën prej 40.000 USD, pa interes, shumë e cila do të likuidohet deri në datën 20.10.2004. Në kushtet e mospërmbushjes së kësaj klauzole të kontratës, kërkuari i është drejtuar gjykatës për të përmbushur detyrimin (kthimin e shumës dhe të kamatëvonesave) në rrugë gjyqësore.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 836, datë 6.2.2012, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë, duke detyruar palën e paditur, N.M. t'i kthejë paditësit Selamet Berisha (kërkuari) shumën prej 40 000 USD.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6762, datë 27.11.2013, në bazë të kërkesës drejtuar gjykatës nga kërkuari, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 836, datë 6.2.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe urdhërimit të Shërbimit Përmbarimor Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

4. Gjithashtu, në lidhje me këtë mosmarrëveshje rezulton se kërkuari ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për shtetasin N.M. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për shtetasin N.M. për kryerjen e veprës penale të mashtrimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 352, datë 17.3.2008, ka vendosur deklarimin fajtor të shtetasit N.M. dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 510, datë 22.9.2008, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 352, datë 17.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit N.M. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin

00-2010-589 (457), datë 7.5.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit. Lidhur me procesin penal kërkuari ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, ku me anë të vendimit nr. 100/2015 Kolegji i Gjyqtarëve ka vendosur mospranimin e kërkesës për shkak të moslegjitimitetit *ratione temporis*.

II

5. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosëkzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë objekt kërkesë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

5.1 Pas marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor kërkuari i është drejtuar shërbimit përmbarimor privat dhe atij shtetëror për të bërë të mundur ekzekutimin e tij. Nga ana e përmbaruesve privatë nuk është gjendur pasuri në emër të debitorit, kurse Zyra Shtetërore e Përmbarimit nuk ia ka ofruar këtë shërbim kërkuarit me arsyetimin se duhet të paguajë 3% të vlerës së detyrimit që kërkohej të ekzekutohet.

5.2 Kërkuari ka paraqitur edhe kallëzim penal në Prokurori, por megjithëse ajo e ka dërguar çështjen për gjykim për veprën penale të mashtrimit, në përfundim debitori është deklaruar i pafajshëm nga gjykatat.

6. Subjektet e interesuara, Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Zyra Përmbarimore Tiranë, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim para Gjykatës lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë, por subjekti i interesuar Avokati i Popullit ka paraqitur vetëm korrespondencën e tij me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, si edhe me kërkuarin në lidhje me këtë çështje.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

7. Kërkuari legjitimohet *ratione personae* t'i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/g të Kushtetutës. Po ashtu, kërkuari legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimi i tij lidhet me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.



B. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

8. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 6762, datë 27.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 836, datë 6.2.2012 të po asaj gjykate.

9. Gjykata ka theksuar në mënyrë konstante se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë. Në këtë kuptim, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, pra vetëm me dhënien e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar nëse nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa vlerë. Karakteri unitar i

procesit civil detyron respektimin e garancive të procesit të rregullt si në fazën e gjyqimit, ashtu edhe të ekzekutimit të detyrueshëm (*shih vendimet nr. 21, datë 7.4.2014; nr. 72, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe të autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 9, datë 14.2.2014; nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Duke e vlerësuar çështjen konkrete në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme, në rastin konkret rezulton se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, 27.11.2013, deri në paraqitjen e kërkesës para kësaj Gjykate ka kaluar një periudhë më shumë se 2-vjeçare. Një periudhë e tillë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor konsiderohet si një afat i paarsyeshëm dhe i gjatë.

i) Kompleksiteti i çështjes

13. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nga shqyrtimi i akteve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata Kushtetuese vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit.



ii) Interesi dhe sjellja e kërkuarit

15. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Gjykata ka theksuar se përdorimi nga ana e kërkuarit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimin nr. 24, datë 27.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete sjellja e kërkuarit përcaktohet nga qëndrimi i tij gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit. Gjykata vlerëson se është kërkuar që është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata vëren se pretendimet e tij kërkuar nuk i ka shoqëruar me dokumente të mjaftueshme provuese. Konkretisht, bashkëngjitur kërkesës janë administruar vetëm disa komunikime ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Drejtësisë (Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit), ndërkohë që nuk ka asnjë dokument tjetër vijues ku të pasqyrohen veprimet procedurale të kërkuarit lidhur me vënien në ekzekutim të vendimit. Në kërkesë thuhet se kërkuar i është drejtuar shërbimit përmbartimor privat, konkretisht shtetasve Vater Kacupi dhe Gentian Strati, por ndërkohë kërkesa nuk është shoqëruar me dokument provues ku të rezultojnë të bazuara këto pretendime apo veprimet procedurale të kryera nga shërbimi përmbartimor privat në rastin konkret. Për më tepër, edhe pretendimi i kërkuarit se përmba-ruesit nuk kanë arritur të gjejnë pasuri të debitorit bazohet në një dokument të vitit 2008, periudhë në të cilën nuk kishte ende një vendim gjyqësor të formës së prerë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në fjalë.

17. Gjykata, bazuar në materialet e paraqitura nga subjekti i interesuar Avokati i Popullit, vëren se kërkuar gjatë periudhës së ekzekutimit ka ngritur disa herë pretendime të paarsyeshme në lidhje me përjashtimin e tij nga pagesa e taksës përmbartimore. Për këtë pretendim rezulton se kërkuar i është kthyer përgjigje nga ana e Avokatit të Popullit me shkresën me nr. 15 prot., datë 12.5.2015, sipas së cilës, bazuar në ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, invalidët nuk përjashtohen nga pagesa e taksës përmbartimore.

18. Gjithashtu, sipas shkresës nr. 7068 prot.,

datë 3.9.2015 të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, Zyra Përmbartimore Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit, rezulton se në datën 15.5.2015 kërkuar ka paraqitur kërkesë pranë kësaj zyre për të pushuar procedurën përmbartimore dhe për të tërhequr dokumentacionin sipas ligjit.

19. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se vetë kërkuar me veprimet e tij është bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor.

iii) Sjellja e autoriteteve

20. Për të përcaktuar sjelljen e autoriteteve në këtë çështje është e nevojshme të vlerësohet nëse shoqëria përmbartimore ka marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nga gjykata.

21. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr. 24, datë 22.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata konstaton se përmbartuesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka qenë i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv, por ka qenë vetë kërkuar i cili ka paraqitur kërkesë për të pushuar procedurën përmbartimore, duke u bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

23. Në përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk konstatohet cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për rrjedhojë kërkesa është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,



VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 52, datë 26.7.2016

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 8.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 18 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Prokuroria e Përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i neneve 13 dhe 14 të Kodit të Procedurës Penale, sipas interpretimit të bërë me vendimin unifikues nr. 2, datë 20.6.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/a, 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi dokumentet e paraqitura, vendimin e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, me të cilin kërkon shfuqizimin e neneve 13 dhe 14 të Kodit të Procedurës Penale, parashtrimet e Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 28.3.2014 Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. 99 ndaj shtetasve A.N., A.N. dhe T.N. (pjesëtarë të së njëjtës familje) për kryerjen e veprave penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” të viktimës P.H. dhe “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” të shtetasit XH.H., e mbetur në tentativë, parashikuara nga nenet 79/c dhe 25 të Kodit Penal (KP).

2. Në përfundim të hetimeve paraprake prokurori ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të shtetasit A.N., ndërsa për shtetasit e tjerë T.N. dhe A.N., me vendimin e datës 26.9.2014, ka vendosur pushimin e hetimeve për shkak të paprovueshmërisë së faktit penal të atribuuar këtyre shtetasve. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në gjykatë personi i dëmtuar nga vepra penale, shtetasi XH.H.

3. Me vendimin nr. 4, datë 9.4.2015, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorit për pushimin e hetimeve dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve për këtë çështje penale. Kundër këtij vendimi prokurori ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda (gjykata referuese). Kjo e fundit, duke vlerësuar se përmbajtja e neneve 13 dhe 14 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) shfaq probleme kushtetutshmërie, si pasojë e interpretimit të bërë me vendimin unifikues nr. 2, datë 20.6.2013 (vendimi nr. 2/2013) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 25.9.2015 ka pezulluar gjykimin e çështjes nr. 31 akti, datë 29.4.2014 dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për kontrollin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së këtyre dispozitave.



II

4. **Gjykata referuese** në vendimin e saj për pezullimin e çështjes ka parashtruar këto shkaqe për të mbështetur pretendimin e saj për shfuqizimin e normave të kundërshtuara:

4.1 Kontrolli i vendimmarrjes së prokurorit në përfundim të fazës së hetimeve paraprake, e konkluduar me pushimin e procedimit penal, është në kompetencë ekskluzive të gjykatës për hetimet paraprake. Si pasojë e interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara, nenet 13 dhe 14 të KPP-së modifikohen në thelbin e përmbajtjes së tyre, duke “transformuar” gjykatat e parashikuara për gjykimin e çështjes në themel, në gjykata që vlerësojnë edhe vendimmarrjen e prokurorit për pushimin e çështjes penale në përfundim të hetimeve paraprake, pra edhe në kushtet e mosekzistencës së akuzës së çështjes.

4.2 Në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave të kundërshtuara, KPP-ja në të njëjtat dispozita, pra në nenet 13/2/a, 14/2 dhe 278/1/2, parashikon se veprimet e prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake shqyrtohen nga gjykata e hetimeve paraprake, e cila është e ndryshme nga gjykata që shqyrton çështjen në themel. Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë për ligj krijimin *de facto* të një gjykate të ndryshme nga ajo e hetimit paraprak, por të ndryshme edhe nga ajo e gjykimit të akuzës në themel, duke anashkaluar përmbajtjen e nenit 278/1/2 të KPP-së, pra duke e konsideruar vendimin e pushimit si akt që nuk i përket fazës së hetimeve paraprake, pra jashtë kompetencës së shqyrtimit nga gjyqtari për hetimet paraprake.

4.3 Përmbajtja e neneve 13 dhe 14 të KPP-së, pas ndërhyrjes së vendimit unifikues, bie ndesh me kufirin e veprimtarisë së pushtetit gjyqësor, i sanksionuar në nenin 135 të Kushtetutës. Përmbajtja e këtyre dispozitave për ligj krijimin e një gjykate *sui generis* të paparashikuar nga sistemi procedural penal shqiptar, në shkelje të përcaktimit kushtetues të nenit 135 të Kushtetutës, sipas të cilit gjykatat krijohen me ligj.

5. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtrori si më poshtë:

5.1 Gjykata referuese nuk ka parashtruar argumente të mjaftueshme për antikushtetutshmërinë e dispozitave objekt kërkesë. Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimit unifikues, ndryshe nga sa pretendon gjykata referuese, nuk e ka modifikuar kuptimin e këtyre dispozitave, por ka përcaktuar se

cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e vendimit të pushimit të hetimeve. Kjo gjë është tërësisht në juridiksionin dhe rolin e Gjykatës së Lartë. Fakti që gjykata referuese ka mendim të ndryshëm për zgjidhjen që i ka dhënë Gjykata e Lartë çështjes së ankimit ndaj vendimit të pushimit, nuk do të thotë se dispozitat e neneve 13 dhe 14 të KPP-së janë antikushtetuese.

5.2 Parashikimi i dispozitave të nenit 13 dhe 14 të KPP-së, sipas interpretimit të bërë nga vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, është konform me Kushtetutën dhe me procesin e rregullt ligjor, pasi i garanton të pandehurit shqyrtimin e ankimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, sipas standardit të vendosur nga GJEDNJ-ja dhe Gjykata Kushtetuese. Shqyrtimi i ankesave ndaj vendimit të pushimit nuk e cenon përbërjen e gjykatës së themelit në raport me funksionin e saj kushtetues në realizimin e dhënies së drejtësisë, pasi ky koncept nuk përfshin vetëm gjykimin në themel të akuzës, por edhe vlerësimin nëse gjatë dhënies së vendimit të pushimit prokurori u është përmbajtur kritereve ligjore.

6. Subjekti i interesuar, Kuvendi, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar sa vijon:

6.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej saj janë të pabazuara dhe nuk e pengojnë atë të vendosë për çështjen, si kusht paraprak për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së një norme ligjore.

6.2 Gjithashtu, argumenti i gjykatës referuese nuk qëndron as në themel, pasi kontrolli i ligjshmërisë së vendimit të prokurorit, i cili në funksion të tij kushtetues ka ndjekjen penale e jo dhënien e drejtësisë, duhet të bëhet nga gjykata. Gjykimi i ankimit të çështjes duhet t'u nënshtrohet rregullave të gjykimit që parashikojnë përbërjen e trupit gjykues sipas nenit 13/3 të KPP-së për gjykimin në shkallë të parë dhe rregullave të parashikuara në nenin 14 të KPP-së për gjykimin në apel.

6.3 Ndryshe nga sa parashtron gjykata referuese, vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 2/2013 nuk ka ndryshuar kuptimin e dispozitave procedurale penale, ky është thjesht perceptim i gabuar i gjykatës referuese. Përkundrazi, ky vendim përjashton mundësinë që kontrolli i vendimeve të



pushimit të prokurorisë të realizohej nga gjyqtari që shqyrton kërkesat mbi hetimin paraprak.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

7. Gjykata çmon të ndalet fillimisht në çështjen e legjitimitimit të gjykatës referuese, i vënë në dyshim nga subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi. Sipas këtyre subjekteve, gjykata referuese nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate, pasi ajo nuk ka dhënë argumente të mjaftueshme dhe bindëse për papajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 13 dhe 14 të KPP-së, si dhe nuk ka vlerësuar siç duhet kriterin e lidhjes së drejtpërdrejt që duhet të ekzistojë mes vlerësimit të kushtetutshmërisë së normës ligjore që duhet të zbatohet gjatë gjykimit të çështjes dhe zgjidhjes së saj nga gjykata referuese.

8. Neni 145/2 i Kushtetutës u njeh të drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur ata çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve të realizuar nga kjo Gjykatë, por që për iniciues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm, të cilat pezullojnë gjykimin kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore ende të pazgjidhur, përfundimi i së cilës varet nga ligji konkret, çmojnë se ligji nuk është i pajtueshëm me Kushtetutën.

9. Gjykata ka theksuar se përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën. Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatohet, midis inter-

pretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimet nr. 55 datë 21.7.2015; nr. 9, datë 26.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, i konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", ka vlerësuar se që të legjitimohet gjykata referuese për iniciimin e kontrollit incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii) të parashtrojë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 26, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata ka theksuar se objekti dhe shkaqet e kërkesës me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues. Në këtë kuptim, në objekt të kërkesës gjykata referuese ka kërkuar shfuqizimin si jokushtetuese të neneve 13 dhe 14 të KPP-së, si pasojë e përmbajtjes së tyre pas interpretimit që u kanë bërë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 2/2013. Referuar shkaqeve në të cilat bazohet vendimi i gjykatës referuese, ky interpretim i bërë nga Gjykata e Lartë bie ndesh me nenin 278 të KPP-së, sepse e konsideron vendimin e pushimit të procedimit penal si akt të marrë jashtë fazës së hetimeve paraprake. Sipas gjykatës referuese interpretimi i bërë nga Gjykata e Lartë nuk është në pajtim as me nenin 141/2 të Kushtetutës, që i jep të drejtën Gjykatës së Lartë të unifikojë



praktikën gjyqësore, si dhe me nenin 135 të Kushtetutës, sipas të cilit gjykatat krijohen me ligj, pasi me interpretimin e saj Gjykata e Lartë ka krijuar një gjykatë të re të ndryshme nga ajo e hetimeve paraprake dhe nga gjykata e gjykimit të themelit.

12. Neni 13 i KPP-së parashikon: “Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Gjykatat për krimet e rënda gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, me përjashtim të kërkesave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, që shqyrtohen nga një gjyqtar.”. Kurse neni 14 i KPP-së parashikon: “Gjykatat e apelit shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore. Gjykata e apelit për krimet e rënda shqyrton në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata për krimet e rënda. Gjykimet për kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 13 shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.”.

13. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 2/2013, në lidhje me çështjen e tretë për unifikim, që i referohet pyetjes: “Cila është gjykata që do të gjykojë kundërshtimin e vendimit të pushimit, gjyqtari i vetëm, apo trupi gjykues prej tre gjyqtarësh, apo gjyqtari që shqyrton kërkesat gjatë hetimeve paraprake?”, ka arsyetuar sa vijon: “Sa i takon caktimit të gjykatës kompetente, në dispozitat referuese të shqyrtimit të ankimit kundër vendimit të pushimit (neni 329 i KPP-së) parashikohet se ankimi bëhet në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe se kundër këtij vendimi ankimi bëhet në gjykatën e apelit. Kurse, duke iu referuar dispozitës procedurale penale që bën fjalë për gjykatën kompetente në fazën e hetimeve paraprake (neni 278 i KPP-së), konstatohet se gjyqtarit për hetimet paraprake i përket vetëm gjykimi i kërkesave të palëve pjesëmarrëse “gjatë hetimeve paraprake”, pra jo i akteve që jepen pas përfundimit të kësaj faze. Vendimi i pushimit apo ai i dërgimit në gjykim janë akte të dala pas përfundimit të fazës së hetimeve paraprake... Sipas nenit 15, pika 2 të KPP-së, duke e trajtuar vendimin e pushimit të çështjes si një vendim quasi gjyqësor, që ka të bëjë me dhënien e drejtësisë, dhe për arsye paanshmërie, kontrolli i vendimit të pushimit të çështjes nuk mund të bëhet nga i njëjti gjyqtar i hetimeve paraprake, i cili ka kontrolluar edhe veprime të tjera gjatë hetimeve paraprake, por nga gjykata

e themelit. Sa më sipër, gjykimi i ankimit kundër pushimit të çështjes duhet t’u nënshtrohet rregullave të gjykimit që parashikojnë përbërjen e trupit gjykues, sipas nenit 13, pika 3 të KPP-së për gjykimin në shkallë të parë dhe sipas rregullave të përcaktuara në nenin 14 të KPP-së për gjykimin në apel.”.

14. Gjykata vëren se gjykata referuese kundërshton mënyrën se si Gjykata e Lartë ka interpretuar në vendimin unifikues përmbajtjen e neneve 13 dhe 14 të KPP-së dhe kërkon shfuqizimin e këtyre të fundit, pasi zbatimi i tyre sipas kuptimit të dhënë nga ai vendim unifikues nuk është në pajtim me Kushtetutën. Pra, edhe pse *de jure* në objektin e kërkesës gjykata referuese kërkon shfuqizim të normës ligjore - konkretisht nenet 13 dhe 14 të KPP-së - *de facto* argumentet i ka të orientuara vetëm mbi vendimin unifikues nr. 2/2013 të Gjykatës së Lartë.

15. Gjykata ka theksuar se sipas interpretimit literal që i bëhet nenit 145/2 të Kushtetutës, çështja e kushtetutshmërisë që i nënshtrohet gjykimit kushtetues gjatë kontrollit incidental ka si objekt një ligj, të cilin gjykata referuese e konsideron si të vesuar nga pikëpamja kushtetuese. Objekt i gjykimit kushtetues, në rastet kur kemi të bëjmë me një kërkesë në rrugë incidentale, është norma, pra rregullimi juridik. Prandaj, gjykata gjykon mbi normën dhe shprehet mbi dispozitën që është parashikimi tekstual/gjuhësor i normës. Dispozita përbën mjetin e nevojshëm të aksesit të normës në gjykimin e gjykatës, gjykim i cili zhvillohet mbi normën, duke e krahasuar atë me përmbajtjen e parimeve dhe të standardeve kushtetuese. Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Sa më sipër vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t’u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për



rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme [...]. Qëllimi i Gjykatës nuk është të vërë në diskutim vlerën që kanë vendimet unifikuuese të Gjykatës së Lartë në rendin juridik dhe as detyrimin ligjor që kanë gjykatat më të ulëta që të marrin parasysh dhe zbatojnë në çështje analoge zgjidhjet e dhëna në këto vendime (*shih vendimin nr. 26, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ajo niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata referuese nuk jep argumente të qarta dhe të mjaftueshme për shfuqizimin e dy dispozitave të KPP-së, të cilat Gjykata i vlerëson si dispozita parimore që përcaktojnë juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave të krimeve të rënda, të shkallë së parë dhe të apelit. Për këtë arsye ato dispozita gjenden në Pjesën e Parë dhe Kreun e Parë të KPP-së. Pra, gjykata referuese kundërshton juridiksionin e gjykatave dhe kompetencën e tyre bazuar vetëm mbi argumentin se këto dy dispozita bien ndesh me një dispozitë tjetër të KPP-së, nenin 278 të KPP-së, i cili gjendet në Pjesën me titull "*Hetimet paraprake*", që lidhet specifikisht me fazën e hetimeve, ndërkohë që gjykatat e kanë të përcaktuar juridiksionin e tyre për të gjitha rastet e parashikuara në KPP-së. Gjykata rithekson se shqyrtimi i përputhjes së dispozitave ligjore me njëra-tjetrën nuk është në funksionin e Gjykatës Kushtetuese, sipas jurisprudencës së konsoliduar të saj.

17. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk ka arritur të japë argumente të nivelit kushtetues se si preken parimet ose standardet kushtetuese drejtpërdrejt nga përmbajtja e neneve 13 dhe 14 të KPP-së, të cilat i kundërshton si antikushtetuese. Në këto kushte,

Gjykata çmon se gjykata referuese nuk plotëson kriteret e legjitimitit, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a, 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 53, datë 26.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 30.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 37 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Zhuljeta Asko

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria "Ujësja Fshat" sh.a., Korçë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e



mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 157, datë 14.5.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë, brenda një afati të arsyeshëm. Detyrimin e subjektit të interesuar të marrë masa për ekzekutimin e detyrimit të përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë së bashku me shpenzimet procedurale në shumën totale prej 727.708 lekësh.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim parashtimet me shkrim të kërkesës, që është shprehur për pranimin e kërkesës, parashtimet me shkrim të subjektit të interesuar, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesja Zhulieta Hasko, prej datës 7.11.2000 ka qenë në marrëdhënie pune pranë shoqërisë “Ujësllësi Fshat” sh.a., Korçë me detyrë K/Dege Financë. Në datën 30.6.2007 i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Duke mos qenë dakord me këtë vendim kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 202, datë 28.1.2008, ka pranuar padinë, duke detyruar palën e paditur të dëmshpërblejë paditësen Zhulieta Hasko me vlerën 560.000 lekë, që përfaqëson dëmshpërblimin për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe shpërblim për vjetërsi në punë.

3. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 157, datë 14.5.2008, ka lënë në fuqi vendimin nr. 202, datë 28.1.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 325, datë 18.6.2008, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 202, datë 28.1.2008, duke ngarkuar Zyrën Përmbarimore Korçë për ekzekutimin e këtij vendimi. Në datën 16.10.2008 Zyra Përmbarimore

Korçë ka nxjerrë urdhrin për vënien e sekuestros konservative në llogarinë e debitorit pranë bankës “Raiffeisen Bank” sh.a. Pas kërkesës nga pala e paditur drejtuar Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 357, datë 3.10.2008, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 202, datë 28.1.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

5. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 362, datë 30.3.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga shoqëria “Ujësllësi Fshat” sh.a., Korçë.

6. Në datën 24.6.2012 është tërhequr dosja nga Zyra Përmbarimore Korçë, duke iu kaluar përmbaruesit privat. Në datën 9.5.2012 ka filluar procedura e ekzekutimit të detyrueshëm në përputhje me Kodin e Procedurës Civile (KPC), duke u urdhëruar vënia e sekuestros konservative ndaj llogarive të debitorit në të gjitha bankat e nivelit të dytë. Për shkak se titullari i institucionit debitor nuk ka ekzekutuar vendimin gjyqësor, në datën 15.4.2013 ndaj tij është vendosur gjobë në masën 50.000 lekë. Kjo gjobë është kundërshtuar nga titullari, por Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka rrëzuar kërkesën me vendimin nr. 263, datë 18.2.2014 (në vendim është arsyetuar se nga titullari nuk është marrë asnjë masë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë).

7. Nga debitori është propozuar një marrëveshje për ekzekutimin me këste, e cila nuk është pranuar nga kërkesja (Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 20, datë 4.4.2014, ka shfuqizuar udhëzimin nr. 2, datë 18.8.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”).

8. Në fund të vitit 2013 dhe fillim të vitit 2014, Këshilli i Ministrave ka kërkuar nga të gjitha institucionet të deklarojnë detyrimet e prapambetura, por shoqëria “Ujësllësi Fshat” sh.a., Korçë nuk e ka pasqyruar këtë vendim gjyqësor në listën e detyrimeve si institucion. Kërkesja i është drejtuar disa herë me shkresat datë 9.10.2014, 14.10.2015 etj. Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në cilësinë e institucionit qendror, por nuk është bërë i mundur ekzekutimi i vendimit gjyqësor. Me shkresën e datës 23.11.2015 kërkesja i është drejtuar Zyrës së Kryeministrit. Me shkresën nr. 5750/2 prot., datë 3.12.2015 kërkesja është vënë në dijeni se kërkesa e saj i është drejtuar për kompetence Ministrisë së Drejtësisë.



II

9. *Kërkuesja Zhulieta Asko* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 12.4.2016, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi edhe pse nga momenti i fillimit të procedurave ka kaluar një periudhë tejet e gjatë, ende nuk është ekzekutuar detyrimi i përcaktuar nga ky vendim.

10. *Subjekti i interesuar, shoqëria "Ujësjellësi Fshat", Korçë* ka parashtruar se përmbaruesi gjyqësor ka refuzuar një marrëveshje për shlyerje detyrimi me këste në vitin 2012, si dhe se mosekzekutimi lidhet me pamundësinë e pagesës për shkak të mospasjes së fondeve.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

11. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individidi, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 52, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vlerëson se kërkuessa ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm dhe se në rastin konkret ajo u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së saj. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor kërkuessa i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si edhe shërbimit përmbarimor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm.

13. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuessa legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj Gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi ajo ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në

dispozicion dhe se nuk ka mjet tjetër për rivendosjen e së drejtës të cenuar.

B. *Për pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm*

14. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr. 21, datë 7.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.

16. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 21, datë 7.4.2014; nr. 14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces



(shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuar, si dhe të autoriteteve përkatëse.

i) Kompleksiteti i çështjes

19. Për vlerësimin e kompleksitetit duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (shih vendimin nr. 15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Gjykata vëren se çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm për pagimin e detyrimeve monetare përkatëse për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. Kjo çështje në vlerësimin e Gjykatës nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojnë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuar dhe autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Interesi dhe sjellja e kërkuar

21. Në rastin konkret interesi i kërkuar është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitoare lidhet me të drejtën e saj për t'u paguar. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuarja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ajo ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

22. Kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 325, datë 18.6.2008, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 202, datë 28.1.2008, duke ngarkuar Zyrën Përmbartimore Korçë për ekzekutimin e këtij vendimi. Në datën 16.10.2008 Zyra Përmbartimore Korçë ka nxjerrë urdhrin për vënien e sekuestros konservative në llogarinë e debitorit pranë bankës "Raiffeisen Bank" sh.a.

23. Në datën 24.6.2012 është tërhequr dosja nga Zyra Përmbartimore Korçë, duke iu dhënë përmbartuesit privat. Në datën 9.5.2012 ka filluar procedura e ekzekutimit të detyrueshëm në përputhje me KPC-në, duke u urdhëruar vënia e sekuestros konservative ndaj llogarive të debitorit në të gjitha bankat e nivelit të dytë.

24. Kërkuarja i është drejtuar disa herë me shkresat e datave 9.10.2014, 3.7.2015, 14.10.2015 etj., Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në cilësinë e institucionit qendror, por akoma nuk është bërë i mundur ekzekutimi i vendimit gjyqësor. Me shkresën e datës 23.11.2015 kërkuarja i është drejtuar Zyrës së Kryeministrit. Me shkresën nr. 5750/2 prot., datë 3.12.2015 kërkuarja është vënë në dijeni se kërkesa e saj i është drejtuar për kompetencë Ministrisë së Drejtësisë.

iii) Sjellja e autoriteteve

25. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (shih vendimin nr. 24, datë 22.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

26. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Në lidhje me autoritetet publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e secilit prej tyre. Në lidhje me sjelljen e debitorit gjykata konstaton se nga ana e këtij të fundit nuk është bërë asnjë përpjekje (apo kanë qenë shumë minimale) për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë. Për më tepër që në mungesë të marrjes së masave konkrete për të mundur ekzekutimin e detyrimit, përmbartuesi, referuar



neneve 517 e 606 të KPC-së, me vendimin nr. 499, prot., datë 15.4.2013, ka gjobitur titullarin e institucionit me gjobë në masën 50.000 lekë. Edhe pas kërkesës së titullarit për kundërshtimin në gjykatë të veprimeve përmbarimore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 263, datë 18.2.2014, duke rrëzuar këtë kërkesë, është shprehur qartë se *“paditësi si titullar i debitorit ‘‘Ujësjiellësi Fshat’’ nuk ka marrë asnjë masë konkrete për të mundësuar ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe se mungesa e fondeve nuk është shkak i justifikuar për të mos ekzekutuar një vendim gjyqësor’’*. Mosmarrja e masave për mosekzekutimin e vendimit lidhet edhe me faktin se në fund të vitit 2013 dhe fillim të vitit 2014 Këshilli i Ministrave ka kërkuar nga të gjitha institucionet të deklarojnë detyrimet e prapambetura, por shoqëria *“Ujësjiellësi Fshat’’* sh.a. Korçë nuk e ka pasqyruar këtë vendim gjyqësor në listën e detyrimeve si institucion.

28. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se afati nga momenti i procedurave të ekzekutimit deri në paraqitjen e kërkesës para Gjykatës është i gjatë dhe përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Veprimet e mësipërme të debitorit nuk krijojnë bindjen te Gjykata se është treguar vullnet për ekzekutimin e vendimit.

29. Gjykata ka theksuar se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet i paekzekutuar dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Bazuar në standardet e mësipërme dhe referuar veprimeve konkrete, si dhe sjelljes së debitorit, Gjykata vlerëson se pretendimi për mungesën e fondeve nuk e shmang debitorin nga detyrimi për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të

formës së prerë. Ai duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për gjetjen e mjetit të përshtatshëm ligjor për të siguruar fondin monetar përkatës, si një detyrim ligjor i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor që tashmë është titull ekzekutiv.

31. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë’’*, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 157, datë 14.5.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 54, datë 27.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“



me sekretare Edmira Pacani, në datën 19.7.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 43 Akti, që i përket:

KËRKUES: Arben Shtëmbari

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 463, datë 16.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 357, datë 23.10.2013 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2015-938, datë 21.5.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4/1, 5/1, 30, 42, 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”; nenet 6/1, 7 dhe 8 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur për shqyrtim çështjen kundër të pandehurve Arben Shtëmbari dhe Laura Sheko për veprën penale të vrasjes me paramendim të shtetasit A.SH. dhe të asgjësimit të kufomës së tij. Gjatë shqyrtimit të provave në gjykatë, prokurori ka tërhequr akuzën duke kërkuar kalimin e akteve prokurorit për të vazhduar hetimet, duke qenë se dolën të dhëna të cilat duhet t'i nënshtrohen hetimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë vendimin nr. 136, datë 25.4.2008 ka pranuar kërkesën e prokurorit për vazhdimin e hetimeve.

2. Prokuroria, pas kthimit të akteve, ka vazhduar veprimtarinë hetimore, pavarësisht se vendimi nr. 136, datë 25.4.2008 është ankimuar nga kërkuari. Gjatë hetimeve Prokuroria ka marrë deklarime nga e pandehura Laura Sheko me procedurën e sigurimit të provës. Në përfundim të

hetimeve, Prokuroria ka paraqitur përsëri kërkesë për gjykim vetëm për kërkuarin Arben Shtëmbari.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 455, datë 17.12.2009, ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit Arben Shtëmbari për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim dhe në bazë të neneve 78 dhe 50/c të Kodit Penal (KP) dënimin e tij me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Arben Shtëmbari për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe në bazë të nenit 278/2 të KP-së dënimin e tij me 4 vjet burgim. Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit Arben Shtëmbari për kryerjen e veprës penale të asgjësimit të kufomës të parashikuar nga neni 303 i KP-së. Në aplikim të nenit 55 të KP-së dënimin e tij përfundimisht me 25 vjet burgim.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 229, datë 5.7.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 455, datë 17.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-87 (7), datë 12.1.2011 ka vendosur prishjen e vendimeve të lartpërmendura dhe kthimin e akteve për rishqyrtim me tjetër trup gjykues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me arsyetimin se provat e marra nga Prokuroria gjatë rihetimit, përfshirë deklarinimet e shtetasës Laura Sheko, janë të pavlefshme për sa kohë vendimi nr. 136, datë 25.4.2008 nuk ishte i formës së prerë, pasi ishte ankimuar nga kërkuari.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në rigjykim të çështjes, me vendimin nr. 463, datë 16.10.2012, ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit Arben Shtëmbari për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendimin dhe në bazë të nenit 78/1 të Kodit Penal (KP) dënimin e tij me 22 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Arben Shtëmbari për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe në bazë të nenit 278/2 të KP-së dënimin e tij me 2 vjet burgim. Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit Arben Shtëmbari për kryerjen e veprës penale të asgjësimit të kufomës të parashikuar nga neni 303 i KP-së. Në aplikim të nenit 55 të KP-së dënimin e tij përfundimisht me 23 vjet burgim.

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 357, datë 23.10.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 463, datë 16.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.



8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-938, datë 21.5.2015 ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga i gjykuari Arben Shtëmbari, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

9. **Kërkuesi**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese. Ai pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtme:

9.1. Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanshmërisë, sepse dy nga gjyqtarët që kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes ishin shprehur më parë për të njëjtën çështje.

9.2. Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë dhe vendimi është marrë mbi prova të pavlefshme, sepse dëshmia e shtetases L.SH., ku bazohen vendimet e gjykatave të faktit, është marrë në kundërshtim me ligjin.

9.3. Është cenuar parimi i barazisë së armëve, sepse gjykatat e faktit ndërkohë që nuk kanë vendosur asnjë kufizim për kërkesat e prokurorit, nuk kanë mbajtur të njëjtin qëndrim me kërkesat dhe pretendimet e të gjykuarit.

9.4. Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit, pasi në vendimet e gjykatave të faktit, që janë kopje e njëra-tjetrës, mungon analiza e fakteve dhe provave, pranimi apo mospranimi i elementëve të përgjegjësisë penale dhe ballafaqimi i tyre me rrethanat e faktit dhe provat.

9.5. Gjykatat kanë tejkaluar kriterin e afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes, pasi procedimi penal ka filluar në vitin 2006 dhe ka vazhduar deri në vitin 2015.

10. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar me shkrim si më poshtë:

10.1. Nuk është cenuar parimi i paanshmërisë sepse: A) Gjyqtari SH.S. ka marrë pjesë në vendimin nr. 00-2015-938, datë 21.5.2015 të Gjykatës së Lartë dhe në vendimin nr. 136, datë 25.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, por nga përmbajtja e këtij të fundit nuk rezulton se cili ka qenë qëndrimi i secilit gjyqtar. Gjithashtu, po nga përmbajtja e vendimit nr. 136, datë 25.4.2008 del qartë se gjykata nuk është shprehur për themelin e akuzës. B) Gjyqtari G.Z. ka qenë pjesë e

Kolegjit Penal që ka marrë vendimin nr. 00-2015-938, datë 21.5.2015, si dhe e trupit gjykues të Kolegjit Penal që kishte marrë vendimin nr. 00-2011-87 (7), datë 12.1.2011, i cili ka kthyer çështjen për rishqyrtim. Nuk rezulton që ky gjyqtar të jetë shprehur në favor të fajësisë së kërkuesit në vendimin nr. 00-2011-87 (7), datë 12.1.2011 të Gjykatës së Lartë.

10.2. Gjykata vërtetësinë e fakteve objekt akuze i ka bazuar në provat shkresore dhe shkencore, të cilat i ka vlerësuar se janë të harmonizuara ndërmjet tyre. Për më tepër kërkuesi nuk përcakton se në cilën pjesë të vendimit gjykata është bazuar te deklaratimet e dhëna nga dëshmitarja L.SH. gjatë sigurimit të provës.

10.3. Kërkuesi nuk ka bërë asnjë referim tek akte konkrete procedurale apo veprime konkrete të gjykatës, të cilat manifestojnë cenimin e parimit të barazisë së armëve.

10.4. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është parashtruar vetëm në formë teorike.

III

A. Në lidhje me formimin e trupit gjykues

11. Gjyqtarët Fatos Lulo dhe Besnik Imeraj, në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kanë kërkuar dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, me argumentin se ata kanë marrë pjesë në gjykimin e së njëjtës çështje në Gjykatën e Lartë. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e ka vlerësuar si të bazuar kërkesën dhe ka vendosur pranimin e saj në përputhje me nenin 36, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për këto arsye çështja është gjykuar nga një trupë e përbërë nga shtatë gjyqtarë.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

B. Për legjitimitimin e kërkuesit

12. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.



Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuksi, *prima facie* legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej tij hyjnë në juridiksionin kushtetues.

C. Për themelin e kërkesës

13. Kërkuksi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është cenuar parimi i paanshmërisë, prezumimi i pafajësisë, parimi i barazisë së armëve, standardi i arsyetimit të vendimit dhe është tejkaluar kriteri i afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes.

14. Gjykata, pasi mori në shqyrtim pretendimet e kërkuksit, gjatë votimit në lidhje me to nuk arriti shumicën e votave të të gjithë anëtarëve për asnjërën prej tyre¹. Në kushtet kur nuk plotësohen kushtet e nenit 73/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe kur asnjë përfundim i çështjes nuk u votua nga shumica e kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit organik, arrin në përfundimin se kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f, 134/1/g, dhe 133/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Atina Xhoxhaj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo

¹ Votuan për pranimin pjesërisht të kërkesës gjyqtarët: Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj.

VENDIM

Nr. 55, datë 27.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 3.5.2016 mori në shqyrtim, në seancë plenare me dyer të hapura, çështjen me nr. 23 Akti, që u përket:

KËRKUES: Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga Ivi Kaso dhe Gazmend Bardhi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga Artur Metani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i paragrafit 3, të nenit 5, të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, datë 30.5.2013.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 42/2, 116, 131/a, 134/1/c dhe 136/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altina Xhoxhaj, pretendimet e përfaqësuesve të kërkuksit, të cilët kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i cili nuk u paraqit në seancë plenare, por paraqiti parashtrimet e tij me shkrim para Gjykatës, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet e përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

1. Neni 5 i ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 8588/2000) parashikonte: “1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë fillon me hyrjen në fuqi të dekretit të Presidentit për emërimin e tij. 2. Mandati i kryetarit të Gjykatës së Lartë llogaritet brenda mandatit të gjyqtarit të kësaj gjykate.”.

2. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) ka miratuar ligjin nr. 151/2013, datë 30.5.2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë””, me të cilin është ndryshuar përmbajtja e nenit 5 të sipërcituar si vijon: “1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë fillon ditën e betimit të tij përpara Presidentit të Republikës, datë e cila i njoftohet zyrtarisht Gjykatës së Lartë dhe përfshihet në dosjen personale të gjyqtarit. 2. Mandati i kryetarit të Gjykatës së Lartë llogaritet brenda mandatit të gjyqtarit të kësaj gjykate. 3. Gjyqtari, të cilit i ka përfunduar mandati apo i ka mbaruar mandati, sipas shkronjës “c” të nenit 139 të Kushtetutës, vazhdon të ushtrrojë detyrën deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës.”.

3. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 95, datë 7.7.2013 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij.

II

4. **Kërkuesi, një grup prej 35 deputetësh të Kuvendit**, në cilësinë e jo më pak se një e pesta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të paragrafit 3 të nenit 5 të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

4.1 Përmbajtja e nenit 136/3 të Kushtetutës është e qartë, koncize dhe mjaftueshmërisht vetë-rregulluese për t’u zbatuar edhe në mungesë të një ligji detajues. Por duke qenë se ndodhemi para rastit kur ligjvënësi ka vlerësuar të nevojshëm rregullimin me ligj, kjo ndërhyrje do të duhej të ishte e tillë që të mos cenonte parashikimin kushtetues të qëndrimit në detyrë “për 9 vjet”.

4.2 Përmbajtja e nenit 5/3 të ligjit nr. 8588/2000 ndryshon në thelb kohëzgjatjen e mandatit kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Dispozita ligjore i jep mundësi atij që të qëndrojë në detyrë edhe përtej mandatit 9-vjeçar, duke sjellë një ndryshim thelbësor në raport me

Kushtetutën, të paaautorizuar nga kjo e fundit. Ky parashikim nuk është në përputhje me vullnetin e kushtetutëbërësit. Përderisa Kushtetuta, ndryshe nga sa ka parashikuar për institucionet e tjera kushtetuese, ka heshtur për zgjatjen e afatit të qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, Kuvendi nuk legjitimohet që një gjë të tillë ta bëjë me ligj. Në këto kushte, parashikimi me ligj i qëndrimit në detyrë tej mandatit 9-vjeçar, deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës, deformon vullnetin e kushtetutëbërësit dhe si i tillë bie ndesh me nenet 4, 7, 116 dhe 136/3 të Kushtetutës.

4.3 Dispozita ligjore e kundërshtuar ka dalë tej parashikimeve kushtetuese edhe në mungesë të një delegimi të shprehur. Përjashtimet nga rregullimi kushtetues nuk mund të vendosen me ligj. Vetë kushtetutëbërësi kur e ka gjykuar të arsyeshme ka bërë përjashtime të posaçme, siç është rasti i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, për të cilin në nenin 125/5 ka lejuar shprehimisht që të vazhdojë të qëndrojë në detyrë deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës. Ndërkohë që në rastin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë kushtetutëbërësi nuk ka njohur asnjë mundësi për vijimin e qëndrimit në detyrë tej mandatit. Në këtë kuadër, çdo dispozitë ligjore që njeh mundësinë e qëndrimit në detyrë tej afatit 9-vjeçar kapërcen dispozitën kushtetuese dhe cenon vullnetin e kushtetutëbërësit.

4.4 Dispozita e kundërshtuar nuk respekton as nenin 136/3 të Kushtetutës, as jurisprudencën kushtetuese, e cila ka bërë dallimin për qëndrimin në detyrë mes gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe atyre të Gjykatës së Lartë. Kjo dispozitë cenon edhe parimin kushtetues sipas të cilit për funksionet kushtetuese të organeve atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Me përmbajtjen e saj dispozita e kundërshtuar e tejkalon Kushtetutën, duke cenuar parimin e shtetit të së drejtës, të shprehur në hierarkinë e normave dhe përparësinë e Kushtetutës.

4.5 Dispozita e kundërshtuar cenon edhe parimin e pavarësisë së gjyqtarit/gjykatës. Nëpërmjet saj *de facto* kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është lënë në diskrecionin e organit që e ka zgjedhur atë. Këtë diskrecion Kuvendi e ka krijuar nëpërmjet një ligji të miratuar prej tij, jashtë delegimit të dhënë nga vetë Kushtetuta. Në këtë mënyrë pavarësia e gjyqtarit/gjykatës vihet në pikëpyetje, duke u cenuar neni 145/1 i Kushtetutës, sipas të cilit



gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Kjo passjell edhe cenimin e nenit 42 të Kushtetutës, i cili sanksionon të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

5. **Subjekti i interesuar, Kuvendi,** në parashtrimet e tij me shkrim ka prapësuar si vijon:

5.1 Dispozita ligjore e kundërshtuar nuk mënjanon ose tejkalon përmbajtjen e ndonjë dispozite konkrete kushtetuese, e cila bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese do të duhej detyrimisht të zbatohet drejtpërdrejt. Vetë Kushtetuta, nëpërmjet neneve 6 dhe 81/2/a të saj, ia nënshton rezervës ligjore absolute çështjen e organizimit dhe funksionimit të organeve dhe institucioneve të parashikuara prej saj, duke i njohur dhe lënë hapësirë Kuvendit që të rregullojë këtë çështje/marrëdhënie. Rregullimi i dispozitës së kundërshtuar hyn brenda rezervës ligjore absolute që këto dispozita kushtetuese i kanë njohur Kuvendit.

5.2 Parashikimi i dispozitës së kundërshtuar është një aspekt i organizimit dhe funksionimit të Gjykatës së Lartë dhe, si i tillë, nuk mund të merret i shkëputur nga vetë procedura e zgjedhjes së këtyre gjyqtarëve. Neni 136/5 i Kushtetutës ia ka nënshtuar rezervës ligjore absolute edhe aspektin e procedurës së zgjedhjes së gjyqtarëve që lidhet me qëndrimin në detyrë të gjyqtarit që i ka mbaruar mandati. Për sa më sipër, në kundërshtim me sa pretendon kërkuesi, në rastin në shqyrtim dispozitat kushtetuese nuk mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

5.3 Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 8588/2000 procedura për zëvendësimin e gjyqtarit që i ka mbaruar mandati fillon jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të tij. Nëpërmjet rregullimit të kundërshtuar, Kuvendi, në cilësinë e tij si ligjvënës, ka synuar të garantojë sa më shumë të jetë e mundur që qëndrimi në detyrë i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, të cilit i ka mbaruar mandati, të mos tejkalojë parashikimin kushtetues prej 9 vjet, i parashikuar në nenin 136/3 të Kushtetutës. Kuvendi, duke marrë në konsideratë funksionin unik dhe ekskluziv që Kushtetuta, në nenin 141 të saj, i ka njohur Gjykatës së Lartë, për njësimin ose ndryshimin e praktikës ligjore, ka miratuar dispozitën e kundërshtuar, në mënyrë që ky funksionon kushtetues të ushtrohet efektivisht edhe gjatë

procedurës së zëvendësimit të gjyqtarit që i ka mbaruar mandati.

5.4 Pretendimin për jokushtetutshmërinë e dispozitës kërkuesi nuk e ka orientuar drejt përmbajtjes së saj, por e ka lidhur me moszbatimin, sipas tij, nga ana e Kuvendit të funksionit për dhënien e pëlqimit për gjyqtarët e emëruar, çka ka të bëjë me aspekte të zbatimit të ligjit dhe si i tillë nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Mosplotësimi i vendeve vakante në përbërjen e Gjykatës së Lartë nuk ka ndodhur për shkak të mosushtimit të funksionit të Kuvendit për dhënien e pëlqimit, por si pasojë e anashkalimit nga ana e Presidentit të parimit të luajalitetit kushtetues, të sanksionuar nga jurisprudenca kushtetuese. Duke qenë se moszëvendësimi i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nuk ka ndodhur për shkak të veprimtarisë së Kuvendit, nuk mund të pretendohet cenimi i nenit 7 të Kushtetutës.

5.5 Gjithashtu, qëndrimi në detyrë i gjyqtarit që i ka mbaruar mandati nuk cenon standardin kushtetues të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës, pasi edhe kjo dispozitë kushtetuese ia ka rezervuar ligjit ekzistencën dhe caktimin e gjykatës.

6. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,** ka prapësuar përpara Gjykatës sa vijon:

6.1 Sipas nenit 136/3 të Kushtetutës gjyqtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi. Lidhur me mundësinë e zgjatjes së mandatit kushtetues për këta gjyqtarë Kushtetuta nuk është shprehur, por, nga ana tjetër, ajo nuk e ndalon ligjvënësin që me ligj të parashikojë mënyrën e ushtrimit të detyrës deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës, në funksion të parimit të vazhdimësisë institucionale dhe shtetit të së drejtës.

6.2 Ligji nr. 8588/2000, i ndryshuar parashikon kushtet dhe kriteret për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe mekanizmi i emërimit përcakton qartë afatet për zëvendësimin e tyre. Në nenin 4 të ligjit parashikohet detyrimi për kryetarin e Gjykatës së Lartë që, jo më vonë se 3 muaj përpara mbarimit të mandatit të gjyqtarit apo menjëherë në rastet e mbarimit përpara afatit ligjor, të njoftojë Presidentin për vendin vakant. Ndërsa i takon Presidentit dhe Kuvendit të bëjnë përzgjedhjen e kandidatëve. Mekanizmi i emërimit të gjyqtarëve të lartë, i parashikuar nga Kushtetuta, në vetvete lejon krijimin e rasteve në të cilat kërkesa e nenit 136/3 të Kushtetutës objektivisht bëhet e



pamundur për t'u respektuar, përderisa Kuvendi ka diskrecion për të vlerësuar jo vetëm plotësimin e kriterëve formale, por edhe meritën e kandidatave të propozuara nga Presidenti.

6.3 Qëllimi i paragrafit 3 të nenit 5 të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar është përcaktimi, mbi të gjitha, i funksionimit normal dhe vazhdimësisë institucionale të Gjykatës së Lartë në rastin e krijimit të vendeve vakante si pasojë e mosveprimit të një prej organeve të cilave Kushtetuta u njeh një rol të veçantë në këtë moment për zëvendësimin e gjyqtarëve të vjetër me gjyqtarë të rinj. Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim do të kishte pasoja në funksionimin e Gjykatës.

6.4 Dispozita e kundërshtuar nuk e ndryshon kohëzgjatjen e mandatit kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, por i jep mundësinë atij që të qëndrojë në detyrë në mënyrë që të sigurohet shërbimi i domosdoshëm në një shtet të së drejtës, ai i dhënies së drejtësisë. Një periudhë e gjatë qëndrimi në detyrë pas mbarimit të mandatit nuk është funksionalisht ekuivalente me një riemërim. Në raport me nenin 116 të Kushtetutës kjo dispozitë nuk sjell një ndryshim të paaautorizuar nga Kushtetuta. Për pasojë, parashikimi me ligj i mundësisë së qëndrimit në detyrë edhe përtej afatit kushtetues 9-vjeçar është në përputhje me vullnetin e kushtetutëbërësit.

6.5 Pretendimi për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, është i pabazuar. Në nenin 136/5 të Kushtetutës është parashikuar procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Dy janë elementet kushtetuese në këtë procedurë, nxjerrja e dekretit të emërimit të anëtarëve dhe dhënia e pëlqimit nga ana e Kuvendit për këto dekrete, por mes këtyre “stacioneve” kushtetuese të emërimit qëndron një procedurë përzgjedhëse, e cila, së pari, është tagër i Kuvendit ta rregullojë me ligj dhe, së dyti, duhet të jetë sa më transparente në funksion të garantimit të një përbërjeje sa më cilësore të Gjykatës së Lartë.

6.6 Pretendimi për cenimin e parimit të pavarësisë së gjyqtarit, sipas nenit 145 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi në rastin konkret mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është i përcaktuar qartë në Kushtetutë dhe në ligjin organik. Po ashtu, nuk është shkelur as standardi kushtetues për një gjykatë të caktuar me ligj, i

sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës, sepse ligjvënësi ka zgjatur në përputhje me dispozitat kushtetuese mandatin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Kushtetuta, në nenin 134/1 të saj, ka përcaktuar rrethin e subjekteve, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, kurse kriteri i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i përcaktuar në pikën 2 të po këtij neni, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në lidhje me legjitimitimin (*locus standi*) e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se ky subjekt, i parashikuar në nenin 134/1/c të Kushtetutës, bën pjesë në subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shtet vendim nr. 19, datë 15.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuar, një grup prej 35 deputetësh të Kuvendit, përfaqëson një subjekt të pakushtëzuar dhe, si i tillë, legjitimohet të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së dispozitës ligjore të kundërshtuar.

B. Për pretendimin për cenimin e parimit të hierarkisë së normave, si element i parimit të shtetit të së drejtës

9. Sipas kërkuarit, dispozita e kundërshtuar tejkalon parashikimin kushtetues të nenit 136/3 të Kushtetutës. Përmbajtja e nenit 5/3 të ligjit nr. 8588/2000 ndryshon në thelb kohëzgjatjen e mandatit kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe kjo dispozitë ligjore i jep mundësi atij të qëndrojë në detyrë edhe përtej mandatit 9-vjeçar, duke sjellë një ndryshim thelbësor në raport me Kushtetutën, të paaautorizuar nga kjo e fundit. Parashikimi me ligj i qëndrimit në detyrë tej



mandatit 9-vjeçar, deri në emërimin e gjyqarit pasardhës, deformon vullnetin e kushtetutëbërësit dhe si i tillë bie ndesh me nenet 4, 7, 116 dhe 136/3 të Kushtetutës. Përderisa Kushtetuta, ndryshe nga sa ka parashikuar për institucionet e tjera kushtetuese, ka heshtur për zgjatjen e afatit të qëndrimit në detyrë të gjyqarit të Gjykatës së Lartë, Kuvendi nuk legjitimohet që një gjë të tillë ta bëjë me ligj. Sipas tij, dispozita ligjore e kundërshtuar ka dalë tej parashikimeve kushtetuese, në mungesë të një delegimi të shprehur, dhe tejkalon Kushtetutën, duke cenuar parimin e shtetit të së drejtës të shprehur në hierarkinë e normave dhe përparësinë e Kushtetutës.

10. Në nenin 4, si dhe në preambulën e Kushtetutës deklarohet parimi i shtetit të së drejtës, i cili është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai është një normë e pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 16, datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i shtetit të së drejtës nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën

tjetër (*shih vendimin nr. 16, datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Neni 4/3 i Kushtetutës parashikon se dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. Përgjatimi kushtetues i parashikuar në këtë dispozitë nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave. Pra, Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Edhe pse disa çështje që lidhen me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit (*shih vendimin nr. 22, datë 24.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata thekson se është brenda hapësirës vlerësuese të ligjvënësit mënyra e rregullimit të një çështjeje të caktuar, ndërsa është detyrë e kësaj Gjykate të kontrollojë nëse ky rregullim është bërë në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore të saj.

14. Sipas nenit 136/3 të Kushtetutës: “Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi”. Bazuar në këtë dispozitë neni 5 i ligjit nr. 8588/2000 parashikonte: “1. Mandati i gjyqarit të Gjykatës së Lartë fillon me hyrjen në fuqi të dekretit të Presidentit për emërimin e tij. 2. Mandati i kryetarit të Gjykatës së Lartë llogaritet brenda mandatit të gjyqarit të kësaj gjykate.” Me ligjin nr. 151/2013, datë 30.5.2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë’”, neni 5 i sipërcituar u ndryshua, duke u shtuar edhe paragrafi 3 (i kundërshtuar) me këtë përmbajtje:



“Gjyqtari, të cilit i ka përfunduar mandati apo i ka mbaruar mandati, sipas shkronjës “c” të nenit 139 të Kushtetutës, vazhdon të ushtrijë detyrën deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës.”. Sipas nenit 139 të Kushtetutës: “1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron kur: a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi; b) nuk paraqitet në detyrë pa arsye për më shumë se 6 muaj; c) mbush moshën 65 vjeç; ç) jep dorëheqjen; d) deklarohet i paafte për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë. 2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë.”. Bazuar në dispozitat e sipërcituara, Gjykata vëren se ligjvënësi ka parashikuar zgjatjen e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në rastin kur atij i përfundon mandati kushtetues 9-vjeçar, si edhe kur ky mandat mbaron për shkak të arritjes së moshës 65 vjeç.

15. Duke e krahasuar përmbajtjen e nenit 136 të Kushtetutës me nenin 125 të saj, Gjykata vëren se për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese kushtetutëbërësi ka bërë një përjashtim për sa i takon qëndrimin të tij në detyrë pas mbarimit të mandatit, duke parashikuar në mënyrë të shprehur në paragrafin 5 të nenit 125 se *“gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij.”*. Në lidhje me këtë parashikim kushtetues Gjykata është shprehur: *“Në ndryshim nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë, neni 125/5 i Kushtetutës parashikon se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij. Rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues është parashikuar për të garantuar, mbi të gjitha, funksionimin normal të Gjykatës në rast të krijimit të vendeve vakante, si pasojë e mosveprimit të ndonjërit prej organeve, të cilave Kushtetuta u jep një rol të veçantë në këtë moment për zëvendësimin e gjyqtarëve të vjetër me gjyqtarë të rinj. Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim do të kishte pasojë në funksionimin e Gjykatës. Në ndryshim sa më sipër, mbarimi ose ndërprerja e mandatit të një gjyqtari kushtetues, në bazë të vendimit të organit që e ka zgjedhur atë dhe jo sipas një procedure ligjore të përcaktuar, me të cilën gjyqtari është njohur dhe e ka pranuar në momentin e zgjedhjes së tij, është e papajtueshme me parimet kushtetuese...”* (shih vendimin nr. 24, datë 9.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Ndërsa në rastin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese kushtetutëbërësi ka parashikuar një rregullim të ndryshëm, si rast përjashtimor për shkak të kompetencave që ushtron dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të kësaj Gjykate, ajo

vlerëson se dispozita kushtetuese që parashikon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Gjykatës së Lartë jo vetëm që nuk përmban një parashikim të tillë të shprehur, por as nuk i ka deleguar ligjvënësit të zakonshëm kompetencën për rregullimin me ligj të kësaj çështjeje. Në praktikë nuk rezulton që norma kushtetuese të jetë interpretuar në një mënyrë të ndryshme apo që të ketë shfaqur paqartësi në zbatimin e saj, çka do të mund të justifikonte një ndërhyrje në nivel ligjor të ligjvënësit.

17. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, dispozita ligjore e kundërshtuar nuk mënjanon ose tejkalon përmbajtjen e ndonjë dispozite konkrete kushtetuese, e cila, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, do të duhej detyrimisht të zbatohet drejtpërdrejt. Vetë Kushtetuta, nëpërmjet neneve 6 dhe 81/2/a të saj, ia nënshton rezervës ligjore absolute çështjen e organizimit dhe të funksionimit të organeve dhe institucioneve të parashikuara prej saj, duke i njohur dhe lënë hapësirë Kuvendit që të rregullojë këtë çështje/marrëdhënie. Sipas tij, parashikimi i dispozitës së kundërshtuar është një aspekt i organizimit dhe funksionimit të Gjykatës së Lartë dhe, si i tillë, nuk mund të merret i shkëputur nga vetë procedura e zgjedhjes së këtyre gjyqtarëve. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, qëllimi i dispozitës së kundërshtuar është të sigurohet funksionimi normal dhe vazhdimësia institucionale e Gjykatës së Lartë në rast krijimi të vendeve vakante, për shkak të natyrës kolegjiale të këtij organi. Dispozita e kundërshtuar nuk e ndryshon kohëzgjatjen e mandatit kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, por i jep mundësinë atij të qëndrojë në detyrë, në mënyrë që të sigurohet shërbimi i domosdoshëm në një shtet të së drejtës, ai i dhënies së drejtësisë. Sipas këtij subjekti, në raport me nenin 116 të Kushtetutës, kjo dispozitë nuk sjell një ndryshim të paautorizuar nga Kushtetuta, për pasojë parashikimi me ligj i mundësisë së qëndrimit në detyrë edhe përtej afatit kushtetues 9-vjeçar është në përputhje me vullnetin e kushtetutëbërësit.

18. Sipas nenit 6 të Kushtetutës organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Gjykata ka theksuar se në rastin e *rezervës ligjore absolute* është norma kushtetuese ajo që ia



rezervon vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënieje konkrete, ndërsa në rastin e *rezervës ligjore relative* çështja konkrete mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore (*shih vendimin nr. 20, datë 4.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet, duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, detyrim që rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai, detyrimisht, do të zbatohet drejtpërdrejt. Për funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji (*shih vendimin nr. 22, datë 24.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata, referuar përmbajtjes së nenit 136/3 të Kushtetutës, vlerëson se kjo normë nuk i ka deleguar ligjvënësit mënyrën e rregullimit të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë tej afatit 9-vjeçar të parashikuar nga Kushtetuta. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se Kushtetuta nuk ka ometuar duke mos parashikuar një autorizim të shprehur për ligjvënësin e zakonshëm për rregullimin e kësaj çështjeje. Rregullimi që ka bërë Kushtetuta në nenin 136/3 të saj është i plotë dhe shterues, për rrjedhojë zbatohet drejtpërdrejt.

20. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e subjekteve të interesuara janë të pabazuara. Në rastin konkret ligjvënësi ka vepruar në tejkalim të normës kushtetuese dhe në mungesë të një delegimi të shprehur, duke rregulluar me akt ligjor një marrëdhënie që i përket fushës së rregullimit të kushtetutëbërësit. Për rrjedhojë, parashikimi i paragrafit 3 të nenit 5 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, datë 30.5.2013, cenon parimin e hierarkisë së normave, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës.

C. Për pretendimet e tjera

21. Sipas kërkesit, dispozita e kundërshtuar cenon edhe parimin e pavarësisë së gjyqtarit/gjykatës. Nëpërmjet dispozitës së kundërshtuar *de facto* kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është lënë në diskrecionin e organit që e ka zgjedhur atë. Këtë diskrecion Kuvendi e ka krijuar nëpërmjet një ligji të miratuar prej tij, jashtë

delegimit të dhënë nga vetë Kushtetuta. Në këtë mënyrë pavarësia e gjyqtarit/gjykatës vihet në pikëpyetje, duke u cenuar neni 145/1 i Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Kjo passjell edhe cenimin e nenit 42 të Kushtetutës, i cili sanksionon të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

22. Një pjesë të natyrshme të rregullimeve kushtetuese zënë normat e lidhura me mandatin e organeve më të rëndësishme të shtetit, të cilat, në mënyrë të veçantë, krijojnë garancitë e nevojshme për ushtrimin e mandatit sipas konceptit kushtetues. Këto garanci konsistojnë, nga njëra anë, në arsye specifike, shteruese për përfundimin e mandatit të tyre dhe, nga ana tjetër, në procedura të veçanta për përfundimin e mandatit/teve. Këto janë elemente përbërëse të statusit kushtetues të organeve dhe institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta. Kjo do të thotë se zëvendësimi i këtyre procedurave specifike me të tjera, më pak mbrojtëse, dobëson statusin e tyre. Në një shtet demokratik të sunduar nga ligji gjyqtari përmbush një funksion shumë të rëndësishëm. Roli i tij dhe i gjykatave në një shtet të tillë është që ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, Gjykata ka vlerësuar se, ndër të tjera, duhet konsideruar edhe mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre (*shih vendimin nr. 20, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohej paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari në momentin e emërimit duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse, dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (*shih vendimin nr. 24, datë 9.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



24. Kurse për sa i takon së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata ka theksuar se një nga elementet e rëndësishme të saj është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas së cilit e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të, t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata, edhe pse më sipër u ndal në evidentimin e standardeve kushtetuese, të cilat pretendohen, gjithashtu, se janë cenuar nga përmbajtja e paragrafit 3, të nenit 5, të ligjit nr. 8588/2000, për sa kohë që ka vlerësuar se dispozita e kundërshtuar, për shkak të mosrespektimit të hierarkisë së akteve dhe tejkalimit të parashikimit kushtetues, bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës, si një nga parimet themelore të shtetit dhe normë e pavarur kushtetuese, nga i cili burojnë edhe parimet e tjera kushtetuese, ajo nuk e sheh me vend të ndalet edhe në vlerësimin e pajtueshmërisë me nenet 42 dhe 145 të Kushtetutës të përmbajtjes së dispozitës ligjore të kundërshtuar.

26. Në përfundim, Gjykata vlerëson se paragrafi 3, i nenit 5, të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, datë 30.5.2013, bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës dhe, si i tillë, duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a dhe 134/1/c të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të paragrafit 3 të nenit 5 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, datë 30.5.2013.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 56, datë 27.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare gjyqësore Edmira Babaj, në datën 19.4.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen nr. 14, Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqata e Mediave Elektronike Shqiptare (SHMESH), përfaqësuar në gjykim nga z. Oljon Kaso.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Alban Brati, z. Gazmend Bici dhe znj. Sonila Kadare.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), përfaqësuar nga znj. Sara Xhumbari.

OBJEKTI: Shpallja si i papajtueshëm me Kushtetutën i paragrafit 3, të nenit 62, të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11/3, 18/1, 124, 131/a dhe 134/1/f të Kushtetutës.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, shqyrtoi pretendimet e kërkuases, e cila kërkoj pranimin e kërkesës, parashtimet e AMA-s, e cila kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Shoqata e Mediave Elektronike Shqiptare (kërkuessa) ka kërkuar shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 62 të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” (ligji për median), me këtë përmbajtje: *“Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë aksionare, që zotëron një licencë kombëtare për transmetimet audio ose një licencë kombëtare të transmetimit audioviziv.”*

II

2. **Kërkuessa** në pretendimet drejtuar Gjykatës Kushtetuese, argumenton se:

2.1. Qëllimi i ligjvënësit për kufizimin e pjesëmarrjes në kapitalin e përgjithshëm të shoqërisë, që zotëron një licencë kombëtare për transmetimet audio ose një licencë kombëtare për transmetimet audiovizive, ka qenë mbrojtja e interesit publik, si shmangia e monopoleve dhe përqendrimeve në një fushë ekonomike me rëndësi strategjike kombëtare dhe njëkohësisht garantimi i pluralizmit të vendimmarrjes në procesin e funksionimit të këtyre lloj shoqërive. Ky qëllim nuk është realizuar, duke u kthyer në një instrument kufizues të së drejtës kushtetuese të personit fizik apo juridik, zotërues të aksioneve, për të ushtruar lirisht aktivitetin tregtar.

2.2. Interesi publik mbrohet jo nëpërmjet kufizimit, por nëpërmjet formave alternative, të tilla si pronësia e ndërthurur apo kufizimet bazuar mbi të dhënat reale të tregut, sikundër dhe po veprohet brenda Komunitetit Evropian nëpërmjet *acquis communautaire*.

2.3. Ligji për mediat vendos kufizime për sa u përket monopoleve ose përqendrimeve në tregun e mediave audiovizive, sikundër janë kufizimet në paragrafët 4, 6, 7, 8, 9 dhe 12 të nenit 62, në lidhje me pronësinë mbi shoqëritë e kontrolluara në tregun e mediave dhe moslejimit të zotërimit të më

shumë se 30% të tregut të reklamave nga një shoqëri radiotelevizive kombëtare, të cilat balancojnë interesin e ligjvënësit për evitimin e monopoleve dhe përqendrimeve në treg, si dhe lirinë e sipërmarrjes dhe barazinë e shtetasve para ligjit, pa iu kufizuar pronësinë atyre.

2.4. Kufizimi i sanksionuar në paragrafin 3 të nenit 62 të ligjit nuk gjendet në asnjë nga legjislacionet evropiane dhe ato rajonale, me përjashtim të Francës, si i tillë është një kundërtendencë ndaj përafrimit të legjislacionit me kuadrin evropian.

2.5. Një kufizim i tillë nuk gjendet në asnjë nga fushat me interes të fortë publik, sikundër janë: arsimit, shëndetësia, siguria dhe farmaceutika. Aplikimi i mekanizmit kufizues mbi pronësinë automatikisht vë në pozitë të ndryshme shtetasit të cilët vendosin t'i përkushtohen një aktiviteti mediatik, në raport me shtetasit të cilët zgjedhin t'i përkushtohen çfarëdo aktiviteti tjetër të ligjshëm ekonomik.

3. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka paraqitur këto prapësime:

3.1. Dispozita objekt kundërshtimi kufizon lirinë ekonomike, por ky kufizim është realizuar për shkak të interesit publik të garantimit praktik dhe efektiv të lirisë së shprehjes dhe së drejtës së informimit.

3.2. Qëllimi që synon kufizimi është që nëpërmjet pengimit të përqendrimit të pronësisë mbi mediat që zotërojnë një licencë kombëtare për transmetimet audio ose audiovizive, të garantojë efektivisht shumëllojshmërinë dhe diversitetin e përmbajtjes programore në fushën audiovizuale, duke evituar situatën që një grup i fuqishëm politik ose ekonomik në shoqëri të ketë një pozicion dominancë mbi këto media.

3.3. Kuvendi ka vepruar brenda hapësirës së vlerësimit të tij në lidhje me përzgjedhjen e mjetit të kufizimit, pra instrumentin ligjor.

3.4. Ndërhyrja e shtetit në lirinë ekonomike nëpërmjet dispozitës objekt gjykimi është diktuar nga situata në të cilën ndodhet liria e shtypit në vend, e vlerësuar si “*pjesërisht i lirë*” sipas raporteve autoritative në këtë drejtim përgjatë viteve.

3.5. Në një vlerësim balancues midis lirisë ekonomike, nga njëra anë, dhe lirisë të shprehjes dhe së drejtës së informimit, nga ana tjetër, pesha e rëndësisë qartësisht anon në favor të lirisë së shprehjes dhe së drejtës së informimit.



3.6. Kufizimi që vendos paragrafi 3 i nenit 62 të ligjit nuk mund të qëndrojë i veçuar dhe i shkëputur nga kufizimet që parashikon paragrafi 4 i këtij neni. Nëse dispozita objekt gjykimi do të shfuqizohej, do të sillte si rrjedhojë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme mundësinë e dyfishit të përqendrimit të pronësisë në mediat që zotërojnë një licencë kombëtare për transmetimet audio ose audiovizive, nga 40%+20% të kapitalit që lejohet sot në shoqëri të ndryshme, në 100%+20% të kapitalit të tyre, duke bërë që pronësia në këto media të përqendrohej edhe më shumë.

3.7. Ndërhyrja është proporcionale, pasi nuk prek të gjitha mediat, por vetëm ato që zotërojnë një licencë kombëtare për transmetimet audio ose audiovizive, të cilat për shkak të kësaj pozite dhe të pushtetit të tyre për të përçuar mesazhin nëpërmjet zërit dhe imazhit, e bëjnë efektin e tyre më të menjëhershëm, më të fortë dhe më të fuqishëm se media e shkruar.

3.8. Subjektet që e ushtrojnë lirinë e tyre ekonomike në fushën e medias, që zotërojnë një licencë kombëtare për transmetimet audio ose audiovizive, nuk ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me personat e tjerë që e ushtrojnë lirinë e tyre ekonomike në fusha të tjera, pasi ushtrimi i lirisë ekonomike në këtë rast bëhet nëpërmjet përdorimit të frekuencave radiotelevizive, të cilat janë pasuri kombëtare e vendit. Për rrjedhojë, pretendimi për diskriminim nuk qëndron, pasi subjektet nuk ndodhen në kushte të njëjta.

3.9. Dispozita objekt kundërshtimi ka qenë objekt edhe i nismës legislative për shfuqizim të ndërmarrë nga deputeti T.B., por u tërhoq përpara se projektligji të shqyrtohej në seancë plenare nga Kuvendi.

4. **Subjekti i interesuar, AMA²**, parashtroi në mënyrë të përmblendhur këto argumente:

4.1. Kriteri kufizues i vendosur në paragrafin 3 të nenit 62 të ligjit për mediat për përqindjen e pjesëmarrjes së aksioneve nuk është në koherencë me ndryshimet në tregun mediatik.

4.2. Kufizimi objekt gjykimi ka pasur si nevojë të ekzistencës garantimin e shumëllojshmërisë në tregun audio dhe audioviziv, që në fakt garantohet me një sërë mekanizmesh të tjerë, si kufizimi i

numrit të licencave që mund të zotërojnë një subjekt tregtar, kufizimi i numrit të programeve, në varësi të llojit të licencës që disponon, për një subjekt të pajisur me licencë për transmetime numerike ose për ofrimin e shërbimit të programit audio ose audioviziv, si dhe kufizimi i përqindjes së reklamave.

4.3. Ky kriter kufizues mund të jetë edhe diskriminues, se për ofruesit e shërbimeve mediatike që ofrojnë shërbime audiovizive në rrjetin e internetit, nuk ka një përcaktim të tillë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Në lidhje me legjitimitimin e kërkeses

5. Gjykata përpara se të shprehet për themelin e çështjes, vlerëson të analizojë paraprakisht çështjen e legjitimitimit (*locus standi*), si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, në cilësinë e “organizatave të tjera”, janë të specifikuar në nenin 134/1/f të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta (*shih vendimet nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 11, datë 6.3.2014; nr. 78, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë

² Dy anëtarët e bordit të AMA-s: Suela Musta dhe Sami Nezaj, me shkresën nr. 1287, prot., datë 19.4.2016, dërguan një opinion të ndryshëm para Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës.



cenim të interesit (*shih vendimet nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 14, datë 21.3.2014; nr. 78, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkesja legjitimohet *rationae persone*, pasi pretendimet bien nën rregullimin kushtetues të nenit 134/1/f të Kushtetutës. Shoqata është një subjekt juridik i krijuar në vitin 2003, i regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 843, datë 4.12.2003, me qëllim dhe objekt veprimtarie kryesore promovimin dhe mbrojtjen e interesave të mediave elektronike shqiptare (*neni 2 i statutit*). Kryetari i shoqatës ka autorizuar personin përfaqësues për paraqitjen e kërkesës pranë Gjykatës, sipas kompetencave substanciale dhe procedurale të përcaktuara në nenin 12/2 dhe 11/4 të statutit. Kërkesja legjitimohet *rationae temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 3 - vjeçar të parashikuar nga ligji. Kjo, pasi ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 37, datë 19.3.2013 dhe ka hyrë në fuqi në datën 3.4.2013, datë nga e cila fillon afati 3-vjeçar për t'iu drejtuar Gjykatës. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës në datën 10.2.2016, duke plotësuar afatin ligjor për paraqitjen e kërkesës.

8. Kërkesja legjitimohet edhe *rationae materie*, sepse pretendimet *prima facie* bien në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Kërkesja ka parashtruar mjaftueshëm se interes vetjak dhe të drejtpërdrejtë ka rivendosjen në kriteret e ligjshmërisë së plotë dhe të transparencës efektive mbi pronësinë e operatorëve mediatikë në tregun kombëtar të mediave audiovizive, që për pasojë do të sjellë operim më të mirë të tyre në treg dhe kontrolle efektive mbi grupet vendimmarrëse.

9. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se shqetësimi i kërkesues është real, pasi pasojat e ardhura në praktikë nga dispozita objekt kundërshtimi prekin çdo operator mediatik, duke sjellë deformimin e mënyrës së rregullt të funksionimit të shoqërive përkatëse në aspektin vendimmarrës, si dhe të shpërndarjes së aksioneve të shoqërive mediatike. Për rrjedhojë, kërkesja ka një interes të sigurt, të drejtpërdrejtë dhe vetjak për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues në funksion të legjitimitetit *rationae materie*.

B. Për pretendimin për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike si rezultat i mospasjes interes publik dhe ndërhyrjes joproporcionale të ligjvënës

10. Kërkesja pretendon se duke qenë se dispozita objekt gjykimi kufizon në përqindje (jo

më shumë se 40%) të drejtën e pjesëmarrjes në kapitalin e përgjithshëm të shoqërive aksionare, mbajtëse të licencave kombëtare për transmetime audio ose audiovizive, për çdo person fizik ose juridik, ajo i ka cenuar lirinë e veprimtarisë ekonomike, të parashikuar nga neni 11 i Kushtetutës.

11. Kushtetuta, në nenin 11, paragrafi 1 dhe 3, të saj, parashikon se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Në zbatim të këtij neni, Gjykata ka elaboruar gjerësisht standardet e lirisë ekonomike, nëpërmjet jurisprudencës së saj, ku shprehet: *‘Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë e qarkullimit të punës, të kapitalit dhe të mallrave pa asnjë kufizim. Në këtë kuptim, individit ka të drejtë të punojë, të prodhojë, të konsumojë dhe të investojë në çdo mënyrë që i pëlqen dhe kjo liri duhet të mbrohet nga shteti. [...] Liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe të shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht e kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti’* (*shih vendimin nr. 24, datë 24.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Po në këtë vendim, Gjykata ka elaboruar edhe rolin e shtetit si ndërhyrës pozitiv, duke u shprehur: *‘... Liria e veprimtarisë ekonomike ka edhe aspektin e saj pozitiv. Ai përmban detyrimin e shtetit që nëpërmjet ligjvënës të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënës shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Në këtë rast, shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator, me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i*



mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike” (ibid).

13. Në vështrim të jurisprudencës së saj, Gjykata afirmon se neni 11 i Kushtetutës, *së pari* shpreh lirinë ekonomike jo vetëm si një e drejtë themelore e individit, por edhe si parim themelor për sistemin ekonomik të vendit tonë, prandaj dhe në parim aktivitetet e natyrës ekonomike nuk duhet të kenë kufizime; *së dyti*, nëse aktivitetet do të përkufizoheshin si të natyrës ekonomike, por me interes publik, atëherë mund të bëhen kufizime, por sipas kriterëve kushtetuese, në përputhje me nenin 11 dhe 17 të Kushtetutës; *së treti*, nëse aktivitetet do të përkufizoheshin si të natyrës joekonomike, atëherë do të ishin aktivitete që u përkasin funksioneve tipike të autoriteteve shtetërore, që nuk bien në rrezen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe mbi të cilat nuk mund të aplikohen garancitë kufizuese kushtetuese, për rrjedhojë individit nuk mund të kërkojë respektimin dhe mbrojtjen sipas nenit 11 dhe 17 të Kushtetutës.

14. Në referim të standardeve kushtetuese të mësipërme, Gjykata vlerëson se ushtrimi i aktivitetit në fushën e medias nga persona fizikë ose juridikë është aktivitet ekonomik me interes të përgjithshëm/publik, i cili mbrohet nga neni 11 dhe 17 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, paragrafi 3 i nenit 62 të ligjit objekt shqyrtimi, i cili kufizon përqindjen e aksioneve të zotëruara nga persona fizikë ose juridikë në kapitalin e shoqërive aksionare, mbajtëse të licencave kombëtare për transmetime audio ose audiovizive, përbën kufizim të lirisë ekonomike.

15. Gjykata çmon se në kushtet kur edhe pala e interesuar, Kuvendi pranon se ka kufizim të lirisë ekonomike në dispozitën objekt shqyrtimi, pa u ndalur më tej në këtë element, duhet të analizohet përmbushja e kriterëve kufizuese, të kontestuara nga palët ndërgjyqëse, nga pikëpamja kushtetuese: i) kufizimi të jetë bërë për arsye të rëndësishme publike/interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve; ii) kufizimi të ketë respektuar parimin e proporcionalitetit.

i) Për pretendimin për mungesën e interesit publik

16. Kërkesja parashtrohet se interesi publik i ligjvënësit nëpërmjet kufizimit ka qenë shmangia e monopoleve dhe përqendrimeve në një fushë ekonomike me rëndësi strategjike kombëtare dhe

njëkohësisht garantimi i pluralizmit të vendim-marrjes në procesin e funksionimit të këtyre lloj shoqërive. Po sipas kërkesës, ky kufizim nuk i përgjigjet aktualisht qëllimit për të cilin është vendosur, në dinamikën e reja të tregut, për rrjedhojë nuk ekziston interes publik mbi dispozitën objekt kundërshtimi.

17. Subjekti i interesuar, Kuvendi, prapëson se ky kufizim është realizuar për shkak të interesit publik, konkretisht për garantimin praktik dhe efektiv të lirisë së shprehjes dhe së drejtës së informimit të qytetarëve.

18. Subjekti tjetër i interesuar, AMA, parashtrohet se kufizimi nuk është në koherencë me ndryshimet në tregun mediatik dhe si i tillë nuk përlligj pasjen e interesit publik, i cili garantohet me kufizime të tjera, përtej kufizimit të aksioneve në kapitalin e përgjithshëm të shoqërisë.

19. Gjykata thekson se koncepte si “interesi publik”, “arsye të rëndësishme publike” apo “veprimtari në interes të përgjithshëm” testohen gjatë kontrollit kushtetues si nocione të natyrës politiko- kushtetuese. Sipas Gjykatës: “... lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë kurrësi shteruese, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Koncepti kushtetues i interesit publik, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para Gjykatës. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese rastet e arsyes publike që të çojnë në kufizimin e një të drejte themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashtë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë.” (shih vendimin nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 7, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Paraprakisht, Gjykata vlerëson të ritheksojë se liria e shprehjes dhe e drejta e informimit, të parashikuara nga nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës, përveç garancisë subjektive si të drejta kushtetuese themelore, janë të lidhura objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik, të deklaruar në preambulën e Kushtetutës sonë. Zbatimi i këtij parimi të rëndësishëm nënkupton edhe garantimin e lirisë së shprehjes, të lirisë së shtypit dhe së drejtës së informimit, si të domosdoshme për një rend të lirë e kushtetues.



21. Parë në këndvështrimin e mësipërm, kjo Gjykatë i ka kushtuar vëmendje të posaçme lirisë së shprehjes, duke theksuar: “Në dallim nga KEDNJ-ja, Kushtetuta jonë garanton lirinë e shprehjes në kuptim të ngushtë dhe të drejtën e informimit në dy dispozita të veçanta, respektivisht në nenet 22 dhe 23 të saj. [...] Liria e shprehjes përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre pushteti shtetëror bëhet më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është, gjithashtu, bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore.” (shih vendimin nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Gjykata i ka vënë theksin edhe pozicionit të “privilegjuar” të medias në një shtet demokratik, duke u shprehur: “...Është pikërisht ajo që e bën pushtetin shtetëror më të prekshëm për njerëzit, më të kontrollueshëm dhe më transparent. Media ndikon që individët e angazhuar në të tria pushtetet, si persona të zgjedhur apo zyrtarë, të kenë disa cilësi të reja. Ata janë më afër me median, më të komunikueshëm me njerëzit, më të kujdesshëm në përmbushjen e detyrave dhe të funksioneve të tyre, si dhe në jetën e angazhimit e tjera shtetërore e private. Media është, gjithashtu, një bazë e rëndësishme për të kontrolluar dhe gjykuar se si funksionarët e veshur me pushtet ushtrojnë autoritetin publik dhe si i menaxhojnë fondet publike. Garantimi i lirisë së medias, ndër të tjera, zvogëlon mundësinë e manipulimeve me pushtetin publik, si dhe nxit identifikimin e rasteve korruptive. Arma e saj më e fuqishme është kritika e vazhdueshme ndaj dukurive negative që rrezikojnë demokracinë, si formë e qeverisjes.” (ibid).

23. Ndërsa, GJEDNJ-ja ka ripërmbledhur parimet e përgjithshme të vendosura në jurisprudencën e saj në lidhje me shumëllojshmërinë në mediat audiovizuale, duke theksuar: “...Nuk mund të ketë demokraci pa pluralizëm. Demokracia përparon bazuar në lirinë e shprehjes. Është thelbësore për demokracinë të lejojë që programet e shumëllojshme politike të propozohen dhe debatohen, madje edhe ato që kanë të bëjnë me mënyrën se si shteti organizohet, me kusht që ato të mos dëmtojnë demokracinë në vetvete. [...] Për të garantuar pluralizmin e vërtetë në fushën audiovizuale në një shoqëri demokratike nuk është e mjaftueshme që të parashikohet ekzistenca e

kanaleve të ndryshme ose e mundësisë teorike për operatorë të mundshëm që të kenë akses në tregun audiovizual. Gjithashtu, është e nevojshme të lejohet një pjesëmarrje efektive në treg, në mënyrë që të garantohet diversiteti i gjithanshëm i përmbajtjeve të programeve, që reflekton, aq sa është e mundur, shumëllojshmërinë e opinionëve që përplasen dhe debatohen në shoqëri, në përputhje me qëllimin e këtyre programeve. [...] Liria e shprehjes, ashtu siç është garantuar në nenin 10, paragrafi 1, përbën një prej themeleve thelbësore të shoqërisë demokratike dhe është një prej kushteve bazike për progresin e saj. Liria e shtypit dhe e informacionit mediatic i jep publikut njërin prej mjeteve më të mira për zbulimin dhe formimin e një opinionimi mbi idetë, veprimet dhe sjelljet e liderëve politikë. I takon shtypit të japë dhe shpërndajë informacion e ide mbi çështjet politike dhe për çështje të tjera të interesit publik. Por jo vetëm shtypi ka detyrë për të dhënë një informacion të tillë, edhe publiku ka të drejtë ta marrë dhe përvetësojë atë” (shih çështjen Evropa Qendrore 7.S.R.L dhe Di Stefano kundër Italisë, vendim i datës 7 qershor 2012, § 129-131).

24. Po kështu, GJEDNJ-ja ka nënvizuar edhe rëndësinë e radios dhe të televizionit, duke u shprehur: “Për shkak të pushtetit të tyre për të përçuar mesazhin nëpërmjet zërit dhe imazhit, një media audiovizuale ka një efekt të menjëhershëm dhe më të fuqishëm se media e shkruar. Funksioni i televizionit dhe radios, si një burim familjar i argëtimit në privatësinë e shtëpisë së dëgjuesit dhe të shikuesit, e bën edhe më të fortë efektin e tyre.” (shih çështjen Evropa Qendrore 7.S.R.L dhe Di Stefano kundër Italisë, vendim i datës 7 qershor 2012, § 132).

25. GJEDNJ-ja ka analizuar edhe aspektin pozitiv të lirisë së shprehjes dhe ka theksuar: “Ushtrimi i vërtetë dhe efektiv i lirisë së shprehjes nuk varet thjesht nga detyrimi i shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të kërkojë të merren masa pozitive të mbrojtjes nëpërmjet ligjeve dhe praktikave të tij. Duke marrë parasysh rëndësinë e asaj çfarë garanton neni 10 i Konventës, shtetet duhet të jenë garantuesit e fundit të pluralizmit. [...] Gjykata konsideron se në fushën e transmetimeve audiovizuale, parimet e parashtruara më sipër i vendosin shtetit detyrimin për të garantuar, së pari, që publiku të ketë akses nëpërmjet TV-së dhe radio-s për një informacion të drejtë dhe të paanshëm dhe për një gamë opinionesh dhe komentesh, të cilat reflektojnë përmbajtjet e shumëllojshme politike brenda vendit dhe, së dyti, që gazetarët dhe profesionistët që punojnë në mediat audiovizuale të mos ndalohen për dhënien, shpërndarjen dhe përmbajtjen e këtij informacioni. Gjykata vëren se në një sektor të tillë sensitiv si ai i mediave audiovizuale, përveç detyrimit negativ për të mos ndërhyrë,



shteti ka detyrimin pozitiv për të krijuar një kuadër legjislativ dhe administrativ për të garantuar pluralizmin efektiv.” (shih çështjen *Manole dhe të tjerët kundër Moldovës*, vendim i datës 17 dhjetor 2009, §.99-100; çështjen *Evropa Qendrore 7.S.R.L dhe Di Stefano kundër Italisë*, vendim i datës 7 qershor 2012, § 134).

26. Për sa më lart, Gjykata riafirmon se liria e shprehjes dhe e drejta e informimit janë të qenësishme për interesat jetikë të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, prandaj në rastin konkret pretendimet e kërkuases për mungesën e interesit publik, si kriter kushtetues për kufizimin në paragrafin 3 të nenit 62 të ligjit për median, nuk qëndrojnë.

ii) Për pretendimin për cenimin e parimit të proporcionalitetit

27. Kërkuësja pretendon se kufizimi në pronësinë e aksionarëve është i ashpër, e tejkalon qëllimin e ligjvënësit për shumëllojshmëri të informacionit dhe nuk i përgjigjet këtij qëllimi, duke sjellë pasoja të padëshiruara në drejtim të cenimit në mënyrë të drejtpërdrejtë të së drejtës së pronësisë së aksioneve, cenimit të lirisë së sipërmarrjes, deformimit të mënyrës së rregullt të funksionimit të shoqërive përkatëse në aspektin vendimmarrës, si dhe të shpërndarjes së aksioneve të shoqërive mediatike.

28. Subjekti i interesuar, Kuvendi, prapëson se ndërhyrja e shtetit në lirinë ekonomike, nëpërmjet dispozitës objekt gjykimi, është diktuar nga situata në të cilën ndodhet liria e shtypit në vend, e vlerësuar si “pjesërisht e lirë” sipas raporteve autoritative në këtë drejtim përgjatë viteve. Kuvendi ka vepruar brenda hapësirës së vlerësimit të tij në lidhje me përzgjedhjen e mjetit të kufizimit, si i nevojshëm dhe i përshtatshëm për kontekstin shqiptar. Ndërhyrja është proporcionale, pasi nuk prek të gjitha mediat, por vetëm ato që zotërojnë një licencë kombëtare për transmetimet audio ose audiovizive, të cilat për shkak të kësaj pozite dhe të pushtetit të tyre për të përçuar mesazhin nëpërmjet zërit dhe imazhit, e bëjnë efektin e tyre më të menjëhershëm, më të fortë dhe më të fuqishëm se media e shkruar.

29. Subjekti i interesuar, AMA, parashtrohet se ligji ka parashikuar masa të tjera, të cilat e garantojnë interesin publik që ky kufizim synon, që është shmangia e monopolit dhe përqendrimeve, prandaj është i panevojshëm.

30. Sikundër kjo Gjykatë ka vlerësuar, në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron “ekuilibrimi i drejtë i interesave”, vlerësimi i rëndësishëm dhe objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit nëse: i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin- ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar- sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t’u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (shih vendimet nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Prandaj dhe ekuilibrimi është metodologjia kryesore që përdoret nga Gjykata, kur ndodhemi para “konfliktit të të drejtave”, për të kuptuar dhe analizuar se kur të drejta të ndryshme konkurrojnë për njerëz apo kategori të ndryshme njerëzish dhe sa janë mbajtur parasysh nga ligjvënësi interesat përkatëse, duke mos konsideruar njërin të drejtë më të rëndësishme se tjetrën ose nëse ky ekuilibër nuk ka mundësi të vendoset, duke përzgjedhur mjetin më pak të dëmshëm ndaj kategorisë e cila gëzon të drejtën e kufizuar.

31. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ballafaqohen interesat e SHMESH-së, që mbrojnë dhe përfaqësojnë interesa të lidhura me lirinë ekonomike, me të drejtën për informim dhe lirinë e shprehjes, si interesa që mbrohen nga ligjvënësi. Në këndvështrim të ekuilibrit të interesave, tri parametrat e mekanizmit ligjvënës ndërhyrës: i) nevoja; ii) domosdoshmëria; iii) përshtatshmëria, i imponojnë ligjvënësit të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në kufizimin e aksioneve në kapitalin e përgjithshëm për personat fizikë ose juridikë, aksionarë në shoqëri mbajtëse të licencave kombëtare të transmetimeve audiovizuale, si ndërhyrje në lirinë ekonomike. Domosdoshmëria e detyron ligjvënësin të vërtetojë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera dhe se ka përdorur mjetin më pak të dëmshëm për subjektet që u kufizohet liria ekonomike. Ndërsa, përshtatshmëria e detyron ligjvënësin të argumentojë se mjeti i



ndërhyrjes është efikas dhe ka sjellë efektet e pritshme dhe të dëshiruara në praktikë.

32. Nën dritën e këtyre konsideratave, Gjykata, për të arritur në një përfundim të drejtë, nëse ndërhyrja e ligjvënësit është proporcionale në raport me gjendjen që e ka diktuar, e shih me vend të bëjë një vështrim krahasues midis paragrafëve të tjerë të nenit 62 dhe paragrafit 3 të tij objekt gjykimi.

33. Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 62 të ligjit për mediat përcaktojnë: *“Licenca kombëtare e transmetimit audio dhe licenca kombëtare e transmetimit audiovizivë u jepen vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizivë. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një licence kombëtare për transmetim audio apo licence kombëtare për transmetim audioviziv, janë nominative”*.

34. Kjo Gjykatë vëren se dy paragrafët e sipërcituar, që përcaktojnë se vetëm shoqëritë aksionare që kanë si objekt ekskluziv të tyre veprimtarinë audiovizive dhe ku aksionet janë nominative mund të mbajnë një licencë kombëtare televizive apo radiofonike, kontribuojnë në transparencën e pronësisë në media.

35. Paragrafi 4 i nenit 62 të ligjit për mediat parashikon: *“Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale”*.

36. Edhe ky paragraf përsëri përcakton kufizime të lidhura me përqindjen e kapitalit të përgjithshëm (20%) në një shoqëri të dytë që zotëron licencë kombëtare, ndërsa për transmetimet analoge audio, kapitali i lejuar është deri në 10% për pjesëmarrjen në një shoqëri të tretë kombëtare.

37. Një kufizim tjetër, që është i lidhur me numrin e licencave lokale apo rajonale, sipas dy kategorive audiovizive ose audio që mund të zotërojnë një subjekt tregtar, parashikohet në paragrafin 7 të nenit 62 të ligjit, sipas të cilit: *“Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë të dytë*

për transmetim audio lokale apo rajonale. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.”

38. Në vijim, paragrafi 8 i nenit 62 të ligjit kufizon përqindjen e aksioneve në kapitalin e përgjithshëm të shoqërisë që zotëron licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, duke parashikuar: *“Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale”*. Ndërsa, paragrafi 9 i ligjit parashikon të njëjtin kufizim të aksioneve, por për subjektet që zotërojnë licenca transmetimi audiovizive lokale apo rajonale, dhe përcakton: *“Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale”*.

39. Në paragrafin 12, dispozita parashikon edhe kufizimin tjetër me karakter ekonomik, që ka të bëjë me moslejimin e zotërimit të më shumë se 30% të tregut të reklamave nga një shoqëri me licencë kombëtare të transmetimit audio ose audioviziv, sipas të cilit: *“Asnjë zotërnës i licencave kombëtare të transmetimeve audio dhe licencave kombëtare të transmetimit audioviziv, përfshirë OSHMA-të, të licencuar për shërbimin e programit audioviziv dhe/ose të autorizuar për shërbimin e programeve të mbështetura në rrjete satelitore, në bazë të këtij ligji, nuk mund të transmetojë më shumë se 30 për qind të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive”*.

40. Nga ana tjetër, edhe AMA, si autoritet monitorues dhe i specializuar në fushën përkatëse, parashitroi para kësaj gjykate se mospërqendrimi në tregun e medias garantohej me një sërë mekanizmesh të tjerë, si: kufizimi i numrit të licencave që mund të zotërojnë një subjekt tregtar, kufizimi i numrit të programeve, në varësi të llojit të licencës që disponon, për një subjekt të pajisur me licencë për transmetime numerike ose për ofrimin e shërbimit të programit audio ose audioviziv, si dhe kufizimi i përqindjes së reklamave.

41. Në vështrim të të gjithë dispozitës që bën rregullimin e pronësisë në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore, Gjykata çmon se tërësia e



nenit 62 të ligjit, edhe pa kufizimin e paragrafit 3, objekt gjykimi, plotëson interesat kushtetues të ligjvënësit për evitimin e monopoleve dhe përqendrimeve në tregun e medias.

42. Duke iu kthyer rolit të AMA-s, Gjykata eidenton se AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, si dhe të shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë (*neni 6 i ligjit*). Disa prej funksioneve kryesore të AMA-s janë: lëshimi dhe heqja e licencave dhe/ose autorizimeve me shumicë të cilësuar; garantimi i konkurrencës së ndershme; bashkëpunimi me institucione të tjera për përmbushjen e objektivave ligjorë, si Autoriteti i Konkurrencës, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit; monitorimi i programeve të transmetuara nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) (*neni 19 i ligjit*). AMA kontrollon zbatimin e ligjit për mediat nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën audiovizive dhe në rast shkeljesh, merr masa administrative dhe vendos sanksione (*neni 132 dhe 133 i ligjit*).

43. Në vështrim të sa më sipër, sipas Gjykatës, AMA, si organ monitorues dhe ligjzbatues, ka kompetenca të gjera lidhur me garantimin e shumëllojshmërisë së informacionit dhe të mospërqendrimit të aksioneve dhe të tregut të medias, ashtu sikundër ka edhe mjete e instrumente për ushtrimin me efektivitet të këtyre kompetencave ligjore.

44. Argumenti i dhënë nga përfaqësuesi i Kuvendit në seancë plenare për mungesën e kapaciteteve kontrolluese të AMA-s dhe të efikasitetit të këtij institucioni monitorues nuk mund të përbëjë arsye të mjaftueshme për kufizimin e lirisë ekonomike të SHEMSH-së. Gjykata çmon se edhe nëse situata në praktikë është e tillë, argumenti i moszbatimit të ligjit nuk mund të përbëjë shkak për kufizim të lirisë ekonomike të kërkujeses. Përkundrazi, Gjykata vlerëson se përforcimi i kompe-tencave monitoruese dhe ndëshkuese të këtij institucioni dhe gjetja e mënyrave dhe instrumenteve të ndryshme të karakterit administrativ, do të ishte një mënyrë qasjeje më efektive ndaj garantimit të shumë-llojshmërisë së informacionit, si qëllimi final i ligjvënësit me kufizimin e realizuar në paragrafin 3 të nenit 62 të ligjit.

45. Duke përzgjedhur mjetin më të ashpër, atë të kufizimit *me ligj*, ligjvënësi tregon, ashtu si dhe në disa çështje të tjera, ku kësaj gjykate i është dashur të shfuqizojë norma ligjore, për shkak të mos-respektimit të parimit të proporcionalitetit, se përzgjedhja e mjetit kufizues nuk vjen si pasojë e një analize të mbështetur mbi të dhëna, statistika, studime të natyrës faktike, ekonomike, politike, sociologjike dhe juridike, në varësi të situatës, si dhe argumente të ekzekutivit/ ligjvënësit se pse zgjodhi mjetin përkatës krahasuar me një tjetër dhe se sa alternativa zgjedhjeje kishte dhe çfarë efekti pozitiv solli mjeti i zbatuar në praktikë efektivisht, *testi post factum* (shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

46. Jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, është shprehur se ligjvënësi duhet të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, domethënë të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Kuvendi prapësoi se ndërhyrja është realizuar sipas një qëllimi të ligjshëm dhe në përputhje me situatën aktuale të lirisë së informacionit dhe nuk tejkalon qëllimin që kërkon të arrijë ligji. Sipas Gjykatës, Kuvendi nuk arriti të provojë se ka gjetur mjetin më të përshtatshëm (kufizimin e aksioneve) në lidhje me lirinë e medias, pra që për shkak edhe të këtij kufizimi liria e medias ka njohur përmirësim.

47. Gjykata thekson se qëllimi që kërkon të arrijë dispozita objekt gjykimi është një qëllim i ligjshëm, por pavarësisht kësaj, ligjvënësi ka detyrimin të bëjë ekuilibrimin e drejtë të interesave, t'i vlerësojë objektivisht ato, të shmangë konfliktin nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre dhe të zgjedhë mjetin kufizues të nevojshëm për realizimin e qëllimit, sipas kontekstit kombëtar.

48. Në këtë këndvështrim, GJEDNJ-ja ka theksuar: “Zgjedhja e mjeteve me anë të të cilave arrihen qëllimet për garantimin e lirisë së shprehjes mund të variojnë sipas kushteve kombëtare dhe për këtë arsye bien brenda marzhit të vlerësimit të vetë shtetit.” (shih çështjen *Manole dhe të tjerët kundër Moldovës*, vendim i datës 17 dhjetor 2009, § 100).

49. Nga ana tjetër, edhe standardet e Këshillit të Evropës në lidhje me pronësinë në media i njohin “hapësirën e vlerësimit” shtetit përkatës, si në instrumentet me të cilat operojnë, ashtu edhe për mënyrën se si mund të arrijnë qëllimet dhe



pikësytimet e interesit të përgjithshëm në nivel kombëtar. Rekomandimi i Këshillit të Ministrave CM/Rec (2007) 2 “Mbi pluralizmin e mediave dhe shumëllojshmërinë e përmbajtjes mediatike” thekson se: *“në mënyrë që të mbrohen dhe promovohen aktivisht opinionet, shprehjet dhe idetë pluraliste, si dhe shumëllojshmëria kulturore, shtetet anëtare duhet të adoptojnë një kuadër ekzistues rregullator, veçanërisht në lidhje me pronësinë e mediave dhe të adaptojnë çdo masë financiare dhe rregullatore me qëllim që të garantojnë transparencën e medias dhe një pluralizëm struktural, si dhe një shumëllojshmëri të përmbajtjeve të përcjella publikut”*.

50. Përveç argumenteve të sipërpërmendura, Gjykata çmon të prezantojë edhe një qasje krahasimore me vendet e rajonit. Kështu, Gjykata konstaton se vende, si Mal i Zi, Maqedonia e Kosova, të cilat kanë ngjashmëri në zhvillimin ekonomik, politik e strukturor, si dhe mendësi të njëjtë me vendin tonë, por edhe problematika të ngjashme për sa i përket lirisë në përgjithësi, dhe lirisë së medias në veçanti, dhe që sipas raporteve autoritative qëndrojnë në të njëjtin nivel listimi³, nuk kanë një kufizim të tillë si ligji shqiptar për median.

51. Gjithashtu, edhe vende të BE-së, si Kroacia, Rumania dhe Italia nuk kanë kufizim të tillë si kufizimi i parashikuar në paragrafin 3 të nenit 62 të ligjit për median, ndërsa Franca, Austria dhe Polonia kanë kufizime deri në 49% të aksioneve, por për persona fizikë ose juridikë të huaj, aksionarë të shoqërive mbajtëse të licencave kombëtare⁴.

52. Për rrjedhojë, edhe në vështrim krahasues, Gjykata konstaton se modeli kufizues i përzgjedhur nga ligjvënësi shqiptar nuk gjendet në asnjë nga legjislacionet rajonale evropiane, si i tillë është një

kundërtendencë ndaj përafrimit të legjislacionit me kuadrin ligjor evropian.

53. Gjykata e gjen me vend të shtojë se edhe direktiva e BE 2010/13, “Për mediat audiovizive”, mbi të cilën, prezumohet se bëhen përafrimet e ligjeve kombëtare për shtetet kandidate për anëtarësim në BE, nuk përcakton kufizime në lidhje me pronësinë e kapitalit të shoqërive që veprojnë në fushën e medias dhe që mbajnë licenca kombëtare audio dhe audiovizive.

54. Gjykata çmon se pavarësisht rëndësisë së objektivit të ligjvënësit dhe pranisë së interesit publik për një sistem mediatik mbështetur thelbësisht në shumëllojshmërinë e informacionit, bazuar në kërkesën kushtetuese për ndërhyrje legjislative proporcionale, në rastin konkret masa kufizuese e parashikuar nuk i shërben ligjvënësit për të përmbushur efektisht objektivin e përcaktuar dhe në këtë kuptim është mjet i papërshtatshëm dhe i panevojshëm.

55. Si konkluzion, Gjykata çmon se mjeti i përzgjedhur nga ligjvënësi për kufizimin e aksioneve të pronësisë së shoqërive që veprojnë në fushën e medias, nuk ka një lidhje të arsyeshme dhe proporcionale me qëllimin e ligjshëm të ligjvënësit për shumëllojshmëri informacioni. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja e ligjvënësit nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, prandaj paragrafi 3 i nenit 62 të ligjit për median duhet shfuqizuar.

56. Në lidhje me pretendimin për cenimin e barazisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet ekonomik në fusha të ndryshme nga ajo e medias, për shkak se nuk kanë kufizime të natyrës objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se ai nuk është ngritur në nivel kushtetues, për rrjedhojë nuk mund të vijojë me analizën e mëtejshme të tij.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a dhe 134/1/f të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash⁵,

³ Sipas organizatës “Freedom House”, në raportin “Për lirinë në botë”, në lidhje me të drejtat politike dhe civile, për vitin 2015, në rankimin nga 1-7, ku 1 përfaqëson vendin më të lirë dhe 7 atë më pak të lirë, listohen vendet për sa vijon: për Shqipërinë 3 nga 7; për Malin e Zi 2,5 nga 7; për Maqedoninë 3.5 nga 7, për Kosovën 4 nga 7. Ndërsa në raportin “Për lirinë e shtypit” për vitin 2015, në rankimin nga 0-100, ku 0 përfaqëson vendin më të lirë dhe 100 atë më pak të lirë, raportohet për sa vijon: për Shqipërinë 49 nga 100; Malin e Zi 39 nga 100; Maqedoninë 58 nga 100, ndërsa Kosovën 49 nga 100. Të dhëna të marra nga websitet:

<https://freedomhouse.org/report/freedom-world/freedom-world-2015>;

<https://freedomhouse.org/report/freedom-press/freedom-press-2015>

⁴ Gjykata i është referuar ligjeve mbi median të vendeve evropiane, të disponueshme, në Platformën Evropiane mbi Autoritetet Rregullatore në fushën e Medias (EPRA), në websitet: <http://www.epra.org/articles/media-legislation>

⁵ Votuan kundër gjyqtari S. Berberi dhe gjyqtarja A. Xhoxhaj.



VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 62 të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”,

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj

MENDIM PARALEL

1. Kërkuesja, Shoqata e Mediave Elektronike Shqiptare, i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 62 të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” (ligjit për median), i cili ka këtë përmbajtje: *“asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë aksionare, që zotëron një licencë kombëtare për transmetimet audio ose një licencë kombëtare të transmetimit audioviziv”*, duke pretenduar, në thelb, se kjo dispozitë cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike të shoqërive mediatike.

2. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka prapësuar se kufizimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike është i arsyeshëm dhe në proporcion me interesin publik për të cilin ligjvënësi e ka parashikuar këtë kufizim dhe ka të bëjë me nevojën për shmangien e situatave të monopolit në mediat që zotërojnë një licencë kombëtare për transmetimet audio dhe audiovizive.

3. Ndonëse pajtohem me vendimin e shumicës për pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të dispozitës objekt shqyrtimi, ndaj mendim të ndryshëm nga ajo lidhur me mënyrën, shkaqet dhe këndvështrimin nga të cilat niset për të vlerësuar themelin e kërkesës.

4. Shumica në vend që të arsyetojë në vendimin e saj mbi pretendimet e kërkueses, ka rënë pre e prapësimeve alogjike të subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, duke argumentuar në detaje dhe nëpërmjet një ndarjeje artificiale nga pikëpamja kushtetuese interesin publik të ligjvënësit në vendosjen e një kufizimi të tillë dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes, të cilat, në mendimin tim, Faqe | 11784

nuk kanë vend të analizohen në një ndërhyrje haptazi të panevojshme dhe arbitrare.

5. Në këtë këndvështrim, vendimi i shumicës *prima facie* është kontradiktor dhe i paqartë. Ai lë vend për keqkuptime dhe keqinterpretime edhe për të ardhmen, nisur edhe nga fakti se vendimet e Gjykatës përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe kanë fuqi detyruese të përgjithshme. Trajtimi konfuz që shumica i bën pretendimit të mungesës së interesit publik (*paragrafët 16 dhe vijues të vendimit*) dhe cenimit të parimit të proporcionalitetit (*paragrafët 27 e vijues të vendimit*), si dhe përdorimi i termave aspak të përshtatshëm kushtetues⁶, është jo vetëm i sforcuar dhe i pavend, por i bie ndesh edhe jurisprudencës së kësaj Gjykate.

6. Në ndryshim nga shumica, në rastin në shqyrtim mendoj se thelbi i kërkesës qëndron në respektimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Kushtetuta në nenin 11 parashikon se sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Jurisprudenca kushtetuese është shprehur në mënyrë të vazhdueshme lidhur me kuptimin dhe rëndësinë e lirisë së veprimtarisë ekonomike, duke e përkufizuar atë si e drejta për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, e drejta për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individ, e drejta për të zgjedhur një punë sipas preferencës, etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave. Po ashtu, liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, lirinë e tregtisë ose mungesën e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, lirinë monetare si masë për të garantuar qëndrueshmërinë e çmimit, lirinë fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për

⁶ Të tilla si *nozione të natyrës politiko-kushtetuese* (shih paragrafin nr. 19 të vendimit ku lexohet: Gjykata thekson se koncepte si “interesi publik”, “arsye të rëndësishme publike” apo “veprimtari në interes të përgjithshëm” testohen gjatë kontrollit kushtetues si *nozione të natyrës politiko-kushtetuese*).



të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lira nga ndërhyrja e shtetit, lirinë e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror, lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Nga ana tjetër, sikurse thekson edhe shumica, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur tashmë mbi pozicionin e “privilegjuar” të medias në një shtet demokratik lidhur me garantimin e lirisë së shprehjes, lirisë së shtypit dhe së drejtës së informimit. Pa respektimin e këtyre të drejtave nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë të qeverisjes. Në këtë drejtim, media ndikon që individët e angazhuar në të tria pushtetet, si persona të zgjedhur apo zyrtarë, të kenë disa cilësi të reja. Ata janë më afër me median, më të komunikueshëm me njerëzit, më të kujdesshëm në përmbushjen e detyrave dhe të funksioneve të tyre, si dhe në jetën e angazhimet e tjera shtetërore e private. Media është, gjithashtu, një bazë e rëndësishme për të kontrolluar dhe gjykuar se si funksionarët e veshur me pushtet ushtrojnë autoritetin publik dhe si i menaxhojnë fondet publike. Garantimi i lirisë së medias, ndër të tjera, zvogëlon mundësinë e manipulimeve me pushtetin publik, si dhe nxit identifikimin e rasteve korruptive. Arma e saj më e fuqishme është kritika e vazhdueshme ndaj dukurive negative që rrezikojnë demokracinë, si formë e qeverisjes (*shih paragrafët 21-22 të vendimit*).

8. Bazuar në sa më sipër, në një shtet të së drejtës, ushtrimi i veprimtarisë ekonomike duhet t’u nënshtrohet respektimit të Kushtetutës dhe ligjeve të vendit. Kështu, rregullat për themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare (aksionare në rastin në shqyrtim), të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të aksionarëve, si dhe riorganizimi dhe likuidimi i tyre, përcaktohen në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Në këtë drejtim, nuk është mënyra e shpërndarjes së aksioneve brenda shoqërisë ajo që përcakton garantimin e lirisë së shprehjes dhe së drejtës së informimit të publikut të gjerë, por përdorimi nga ana e shtetit e mjeteve të

përshtatshme (kontrolleve), nëpërmjet organeve të posaçme (AMA), për të vënë kufizimet e duhura në media. Prandaj, përcaktimi i kufizimeve mbi përqindjen e mbajtjes së aksioneve në shoqëritë e mediave që zotërojnë një licencë kombëtare për transmetimet audio dhe audiovizive, si nevojë për shmangien e situatave të monopolit, është alogjik, sepse shteti ka mjete të tjera ligjore në dispozicion për të kontrolluar dhe parandaluar këto situata. Të njëjtën qëndrim kanë mbajtur edhe pothuajse të gjitha vendet evropiane, të cilat në legjislacionet e tyre nuk kanë kufizime të tilla mbi përqindjen e mbajtjes së aksioneve në shoqëritë e mediave.

9. Si përfundim, për të gjitha argumentet e mësipërme, vlerësoj se shpërndarja e kapitalit brenda shoqërisë aksionare, qofshin këto edhe mediatike, është çështje që u përket ortakëve dhe del jashtë interesit të shtetit. Këto janë arsyet për të cilat mendoj se kërkesa e paraqitur nga Shoqata e Mediave Elektronike Shqiptare është e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese ka vendosur pranimin e kërkesës së Shoqatës së Mediave Elektronike Shqiptare, duke shfuqizuar paragrafin 3 të nenit 62 të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” me këtë përmbajtje: “*Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë aksionare, që zotëron një licencë kombëtare për transmetimet audio ose një licencë kombëtare të transmetimit audioviziv.*”

2. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, të parashikuar nga neni 11 i Kushtetutës, si rezultat i kufizimit në përqindje (jo më shumë se 40%) të së drejtës së pjesëmarrjes në kapitalin e përgjithshëm të shoqërive aksionare, mbajtëse të licencave kombëtare për transmetime audio ose audiovizive, për çdo person fizik ose juridik.

3. Jurisprudenca kushtetuese është shprehur në mënyrë të vazhdueshme lidhur me kuptimin dhe rëndësinë e lirisë së veprimtarisë ekonomike, duke e pasuruar kuptimin e nenit 11 të Kushtetutës apo edhe raportin e tij me nenin 17.

4. Për sa i takon çështjes kryesore të diskutueshme, asaj të pluralizmit në media në drejtim të



shumëllojshmërisë së programacioneve, mendoj se kushtëzohet nga pluralizmi në pronësinë e medias dhe në rregullimin e pronësisë. Rregullat në pronësinë e medias janë si të natyrës së kufizimeve fikse, ashtu edhe të kufizimeve të ndryshueshme. Po ashtu është njohur nevoja për të vlerësuar e rishikuar efikasitetin e rregullave që promovojnë pluralizëm në media e diversitet në përmbajtje nën dritën e zhvillimit teknologjik, ekonomik e shoqëror të një vendi.

5. Referuar jurisprudencës kushtetuese është pranuar qëndrimi se është në diskrecionin e ligjvënësit përzgjedhja e mjetit më të përshtatshëm për të garantuar media të lirë përmes kufizimeve që nuk cenojnë thelbin e së drejtës së pronësisë. Po ashtu, është e njohur edhe kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar efektivitetin, përshtatshmërinë dhe domosdoshmërinë e mjetit të zgjedhur nga ligjvënësi. Në çështjen konkrete, kufizimet që burojnë nga ligji në tërësi janë të shumta në numër, por veçanërisht ato të parashikuara nga neni 62, specifikisht nga pika 3, janë të ashpra. Në këtë kuptim, shfuqizimi i nenit 62/3 sjell lehtësim në kufizimin e së drejtës së pronësisë dhe vendos një balancë më të drejtë midis kufizimit dhe interesit publik për një media të lirë në një shtet demokratik.

6. Heqja e kufizimit ligjor në përqindjen e aksioneve të zotëruara nga persona fizikë ose juridikë në kapitalin e shoqërive aksionare, mbajtëse të licencave kombëtare për transmetime audio ose audiovizive, nuk krijon përqendrim të tepruar të pronësisë në media, pasi ligji objekt shqyrtimi dhe legjislacioni në fuqi parashikon instrumente të tjera rregullatore, siç është Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), që siguron pluralitetin në programacion apo Autoriteti i Konkurrencës, që siguron shmangien e pozitës monopol në fushën e medias. E vetmja sfidë në këtë kontekst mbetet funksionimi i tyre në përputhje me ligjin.

Anëtare: Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe me argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, prandaj e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice. Shumica ka arritur në konkluzionin se mjeti i përzgjedhur nga ligjvënësi për kufizimin e aksioneve të pronësisë së shoqërive që veprojnë në fushën e medias nuk ka një lidhje të arsyeshme dhe proporcionale me qëllimin e ligjshëm të ligjvënësit për pluralitet informacioni dhe, për rrjedhojë, paragrafi 3 i nenit 62 të ligjit për median duhet shfuqizuar [prg. 55 i vendimit].

2. Shumica e mbështet konkluzionin e saj për ashpërsinë e mjetit të përzgjedhur nga ligjvënësi në dëm të lirisë ekonomike të kërkuesit, në tri argumente kryesore: i) tërësia e nenit 62 të ligjit edhe pa kufizimin e paragrafit 3 objekt gjykimi plotëson interesat kushtetues të ligjvënësit për evitim të monopoleve dhe përqendrimeve në tregun e Medias [prg. 41 i vendimit]; ii) AMA si organ monitorues dhe ligjzbatues ka kompetenca të gjera lidhur me garantimin e pluralitetit të informacionit dhe mospërqendrimin të aksioneve dhe të tregut të medias, ashtu sikundër ka edhe mjete dhe instrumente për ushtrimin me efektivitet të këtyre kompetencave ligjore [prg. 43 i vendimit]; iii) modeli kufizues i përzgjedhur nga ligjvënësi shqiptar nuk gjendet në asnjë nga legjislacionet rajonale evropiane, si i tillë është një kundërtendencë ndaj përafrimit të legjislacionit me kuadrin ligjor evropian [prg. 52 i vendimit]. Mendojmë se argumentet e mësipërme nuk janë bindëse dhe të mjaftueshme për të konkluduar se dispozita objekt shqyrtimi nuk është në përputhje me Kushtetutën, për arsyet dhe kundërgargumentet që vijojnë.

3. Parimi kushtetues i proporcionalitetit, në rastet e kufizimit të të drejtave të njeriut, i imponon ligjvënësit detyrimin për të përcaktuar qëllimin e ligjshëm dhe mjetin për ta arritur atë, kurse Gjykata kontrollon mjetin kufizues dhe masën e ashpërsisë. Ky kontroll bëhet në aspektin e përputhshmërisë me qëllimin dhe interesin e ligjshëm që kërkon të arrijë ligjvënësi dhe nëse masa e tejkalon apo jo “dukshëm” këtë qëllim, si masë shtrënguese. Gjykata nuk kontrollon nëse masa është oportune apo jo. Kjo është në diskrecionin dhe fushën e vlerësimit të ligjvënësit.

4. Në rastin konkret, interesi i ligjvënësit për transparencën e medias dhe pluralitetin e informacionit ka qenë mjaftueshëm i rëndësishëm për të ndërhyrë në nenin 62 të ligjit për median nëpërmjet paragrafit 3 objekt gjykimi. Edhe shumica ka pranuar se qëllimi që kërkon të arrijë dispozita objekt gjykimi është një qëllim i ligjshëm [prg. 47 i vendimit].



5. Nga përfaqësuesi i Kuvendit u mbajt qëndrimi se dispozita konkrete është gjetur si më e përshtatshme në kontekstin shqiptar dhe si e nevojshme për të arritur qëllimin e synuar nga ligjvënësi për pluralitetin e informacionit. Sipas tij, në muajin prill të vitit 2015, me nismën e një deputeti, u paraqit një projektligj për shfuqizimin e nenit 62 të ligjit për median, të cilin Komisioni Parlamentar për Median e vlerësoi si të papranueshëm dhe për këtë arsye vendosi unanimisht rrëzimin e tij.

6. Shumica e ka konsideruar të pabazuar qëndrimin e mësipërm të ligjvënësit dhe ka konkluduar se mjeti i përzgjedhur nga ligjvënësi është i panevojshëm dhe i padobishëm [prg. 54 i vendimit]. Duke mos qenë dakord me këtë konkluzion, vlerësojmë se nga ana e kërkuarit nuk janë paraqitur argumente të mjaftueshme për të mbështetur qëndrimin se ka pasur mjete të tjera më pak të ashpra për të arritur qëllimin e kërkuar, të cilat do ta çonin Gjykatën në konkluzionin se ky kufizim është i panevojshëm.

7. Ndryshe nga sa argumenton shumica, kufizimi që vendos paragrafi 3 i nenit 62 të ligjit, nuk mund të qëndrojë i veçuar dhe i shkëputur nga kufizimet që parashikon paragrafi 4 i këtij neni. Shfuqizimi i paragrafit 3 të ligjit sjell si rrjedhojë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme mundësinë e dyfishimit të pronësisë në mediat të cilat zotërojnë një licencë kombëtare për transmetimet audio ose audiovizive, nga 40%+20% të kapitalit që lejohet sot në shoqëri të ndryshme, në 100%+20% të kapitalit të tyre, duke bërë që pronësia në këto media të përqendrohet edhe më shumë. Prandaj edhe në këtë këndvështrim qasja krahasimore mes paragrafit 3 dhe paragrafit 4 të nenit 62 duhet ta kishte çuar shumicën në konkluzionin e nevojës së këtij kufizimi dhe jo në të kundërtën.

8. Po kështu edhe krahasimi me legjislacionet e vendeve të tjera evropiane në këtë rast nuk mund të jetë kriter orientues për arritjen e konkluzionit të shumicës, pasi ashpërsimi ose zbutja e kufizimit ndryshon në varësi të situatës së lirisë së shprehjes dhe demokracisë në vend. Ligjvënësi i disponon mjetet e tij të reagimit për të përmirësuar situatën sipas kontekstit kombëtar. Në mbështetje të këtij qëndrimi, siç u përmend edhe më sipër, lidhur me vlerësimin e mjetit të zgjedhur dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, ligjvënësi ka një hapësirë të lirë dhe të gjerë veprimi, e cila mund të shqyrtohet në

shkallë të kufizuar nga kjo Gjykatë (*shih vendimet nr. 71, datë 27.11.2015; nr. 55 datë 21.7.2015; nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Shumica ka vlerësuar se kufizimi me ligj në këtë çështje nuk ka ardhur si pasojë e një analize të mbështetur mbi të dhëna, statistika, studime të natyrës faktike, ekonomike, politike, sociologjike dhe juridike, në varësi të situatës, si dhe mbi argumente se pse është zgjedhur mjeti përkatës krahasuar me një tjetër, çfarë alternativash zgjedhjeje janë shqyrtuar dhe çfarë efekti pozitiv ka sjell mjeti i zbatuar në praktikë efektivisht, *testi post factum* [prg. 45 i vendimit]. Ndryshe nga shumica, vërehet se ka një sërë analizash dhe statistikash të autoriteteve ndërkombëtare që kanë vlerësuar gjendjen e lirisë së medias dhe pluralitetin e informacionit në vendin tonë për t'u pasur parasysh në një analizë *post factum*. Kështu, *Progres Raporti i Komisionit Evropian* për Shqipërinë për vitin 2015 ka vërejtur: "Pronësia e mediave është bërë më transparente, por vazhdojnë të mbeten shqetësime për pronësinë e fshehur. Mungesa e transparencës në financimin e medias mbetet problematike. Mbetet shqetësim shpërndarja e reklamave shtetërore dhe fondeve publike për pronarë të mediave dhe bizneseve afër qeverisë, pasi kjo ndikon në konkurrencën e ndershme ndërmjet bizneseve të medias. Ndryshimi i propozuar për të hequr limitet e pronësisë për median audiovizive ka shkaktuar shqetësime, sepse do të lehtësojë krijimin e monopolit në sektorin e medias audiovizive"⁷.

10. Në Raportin Global të "Freedom House" për lirinë e shtypit 2015, pronësia mbi median raportohet e fshehur nëpërmjet përdorimit të veprimeve fiktive, të cilat shmangin barrierat ligjore të vendosura për të penguar përqendrimin e pronësisë. Konkretisht, statistikën për Shqipërinë janë: liria e shtypit: 49 pikë nga marzhi 0 më i lirë - 100 më pak i lirë; statusi: pjesërisht i lirë; kuadri ligjor: 15 nga 0-30 pikë; mjedisi politik: 17 nga 0-40 pikë; mjedisi ekonomik: 17 nga 0-30 pikë.⁸

11. Po kështu, në studimin "Study of freedom of media in the Western Balkans" [Studimi i lirisë së Medias në Ballkanin Perëndimor] për Shqipërinë është

⁷ Progresraporti 2015 për Shqipërinë, i Komisionit Evropian, f. 21 dhe f. 58.

⁸ Organizata "Freedom House" në Raportin mbi lirinë e Medias për vitin 2015, e disponueshme online: <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2015/albania>



vërejtur se ka shqetësime që pronarët e shumë mediave janë përfshirë në veprimtari të ndryshme biznesi përtej kompanive të tyre mediatike dhe kjo shpesh i përfshin ata në pjesëmarrjen e tenderave publikë. Interesat e ndërthurur ekonomikë sjellin që pavarësia e medias të kërcënohet seriozisht.⁹

12. Në këtë linjë edhe Nënkomiteti i 8-të i Inovacionit, Shoqërisë së Informacionit dhe Politikave Sociale të Bashkimit Evropian – Shqipëri për politikën audiovizuale në Shqipëri lidhur me zgjidhjen e shqetësimeve të përqendrimit të pronësisë në sektorin mediatik *ka rekomanduar dhe nxitur autoritetet shqiptare për të zbatuar kufizimet ligjore në fuqi*.¹⁰ Po kështu, gjatë procesit legjislativ për shfuqizimin e nenit 62 të ligjit, Kuvendi iu ofrua ekspertizë edhe nga Këshilli i Evropës, i cili konkludoi: “*Shfuqizimi i këtij neni, pa instaluar asnjë siguri kompensuese për të parandaluar një përqendrim të pajustifikuar të pronësisë në tregun shqiptar të transmetimeve tokësore, krijon një situatë që shkon kundër standardeve evropiane në lidhje me pluralizmin e medias. Panorama mediatike në Shqipëri aktualisht karakterizohet nga: një përqendrim horizontal dhe vertikal në treg; një ndikim i lartë i televizionit tokësor në formimin e opinionit publik; një ndërveprim i fuqishëm mes interesave të medias, politikës dhe biznesit*.”¹¹

13. Bazuar në analizën dhe argumentet e mësipërme vlerësojmë se qëndrimi i shumicës, e cila ka konkluduar se kufizimi është i panevojshëm dhe i padobishëm, më shumë se në argumente kushtetuese, mbështetet në vlerësime lidhur me përshtatshmërinë dhe oportunitetin e kufizimit, të cilat i përkasin hapësirës dhe diskrecionit të ligjvënësit. Në të njëjtën linjë është mbajtur qëndrim edhe në disa raste të tjera të ngjashme, ku është theksuar: “Gjykata Kushtetuese nuk ka

kompetencë të vlerësojë nëse rregullimi ligjor është më i drejtë apo më i përshtatshëm për arritjen e qëllimit të shprehur nga ligjvënësi. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse kufijtë e jashtëm të hapësirës vlerësuese të ligjvënësit janë kapërcyer ose jo” (shih pakicën të vendimi nr. 9, datë 26.2.2016 i Gjykatës Kushtetuese).

14. Si konkluzion, pretendimet e kërkuarit për jokushtetutshmërinë e paragrafit 3, të nenit 62, të ligjit për median nuk janë të bazuara, për rrjedhojë kërkesa duhej rrëzuar.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 57, datë 29.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 8.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 32 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Gjykata e Lartë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të shkronjës “ç”, pika 2 e nenit 33 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 36 i ligjit nr. 9877 datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 21 i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve adminis-

⁹Dokument i Departamentit të Politikës, Drejtoria e Politikave me Jashtë të Bashkimit Evropian, Parlamenti Evropian, *Study of freedom of media in the Western Balkans*, [Studimi i lirisë së Medias në Ballkanin Perëndimor], tetor 2014, f. 14.

E disponueshme online:

[http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2014/534982/EXPO_STU\(2014\)534982_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2014/534982/EXPO_STU(2014)534982_EN.pdf).

¹⁰ Dokument i paraqitur nga Kuvendi me shkresën nr. 1443/2 prot. të datës 5.5.2016.

¹¹ Opinion i Departamentit të Shoqërisë së Informacionit të Drejtorisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Aksionit kundër Krimit, Drejtorisë së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit, përgatitur nga Sekretariati bazuar mbi ekspertizën e ekspertës së pavarur të Këshilli të Evropës, dr. Peggy Valcke, për projektligjin “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013, “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, datë 17 korrik 2015.



trative”; nenet 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e gjykatës referuese, që kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Ministri i Drejtësisë, me kërkesën nr. 302 prot., datë 15.1.2014, “Për procedimin disiplinor të gjyqtarës E.Gj.” i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë me propozimin për marrjen e masës disiplinore shkarkim nga detyra.

2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 29, datë 24.2.2014, “Për shqyrtimin e kërkesës për procedim disiplinor ndaj gjyqtarës E.Gj.”, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarës E.Gj., si dhe caktimin e afatit deri në mbledhjen e ardhshme për propozimin e një mase tjetër disiplinore.

3. Në mbledhjen e datës 15.4.2014, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për marrjen e masës disiplinore ndaj gjyqtarës E.Gj. për dërgimin nga 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij.

4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 44, datë 15.4.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë dhe bazuar në shkronjën “ç”, pika 2, e nenit 33 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka marrë masën disiplinore të dërgimit për dy vjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për të ushtruar detyrën e gjyqtarës.

5. Me pretendimin se masa e marrë është e pabazuar në ligj dhe joproporcionale, gjyqtarja E.Gj. i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 54, datë 3.6.2014, ka vendosur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, si dhe dërgimin e saj Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

7. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë pasi ka shqyrtuar çështjen me vendimin nr. 15, datë 30.9.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

8. Mbi rekursin e palës paditëse E.Gj., Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi e bisedoi çështjen në tërësi, ka vlerësuar se dispozita e shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 33 të ligjit nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e cila zbatohet për zgjidhjen e çështjes, vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Në këto kushte, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin në Gjykatën Kushtetuese.

II

9. **Kërkuesi Gjykata e Lartë (gjykata referuese)**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar antikushtetutshmërinë e shkronjës “ç”, pika 2, e nenit 33 të ligjit 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e cila parashikon masën disiplinore: “*Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij*”. Gjykata referuese në mënyrë të përmblodhur ka parashtruar si vijon:

9.1 Dispozita objekt kundërshtimi nuk ka lidhje me qëllimin dhe kuptimin e transferimit që parashikon pika 4 e nenit 147 të Kushtetutës.

9.2 Në Kushtetutë nuk parashikohet transferimi i gjyqtarit si një nga llojet e masave disiplinore që mund të merret ndaj tij. Në Kushtetutë parashikohet se për transferimin e gjyqtarit, sikurse dhe për përgjegjësinë disiplinore, vendos Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Norma kushtetuese parashikon në mënyrë të shprehur se transferimi i gjyqtarit nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tij, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor.

9.3 Transferimi paralel, pa pëlqimin e gjyqtarit, nuk mund të parashikohet nga ligji si një masë disiplinore kryesore, por vetëm si masë plotësuese, që shoqëron kur është rast masën kryesore të dhënë ndaj gjyqtarit.

9.4 Ligji duhet të parashikojë lloje masash disiplinore që jo vetëm të jenë të përshtatshme me natyrën dhe funksionin kushtetues të gjyqtarit, por edhe të mos cenojnë parimet themelore për pavarësinë dhe palëvizshmërinë e gjyqtarit në ushtrimin e detyrës.



9.5 Transferimi i gjyqtarit në një gjykatë paralele, pa pëlqimin e tij, si masë disiplinore, vjen në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit dhe atë të mosdiskriminimit. Kjo dispozitë krijon gjendje objektive paragjyqese, diskriminuese dhe pabarazie përpara ligjit ndërmjet subjekteve dhe individëve që i drejtohen gjykatës. Qëllimi i ligjit dhe pritshmëria është që gjykatat e së njëjtës shkallë të kenë gjyqtarë në thelb të të njëjtit nivel në aspektin profesional dhe të integritetit.

10. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka paraqitur parashtrime me shkrim si vijon:

10.1 Gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi ka çmuar se ligji që do të zbatohet në çështjen konkrete bie në kundërshtim me Kushtetutën. Bazuar në nenin 131/a të Kushtetutës kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit është në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës Kushtetuese.

10.2 Lidhur me themelin e kërkesës, Gjykata Kushtetuese është shprehur më parë me vendimin nr. 21, datë 7.6.2007 për pikën 5, të nenit 42, të ligjit nr. 8436, datë 18.12.1998, "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" që parashikonte si masë disiplinore transferimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të ulët. Ajo ka vendosur shfuqizimin e saj, pasi transferimi si masë disiplinore nuk ishte konceptuar sipas standardeve kushtetuese.

10.3 Gjykata Kushtetuese me vlerësimet e mbajtura në vendimin e mësipërm, duke u shprehur se si duhet të jenë rregullimet e ardhshme eventuale ligjore, ka ndërhyrë në tagrat e pushtetit legjislativ që i takojnë Kuvendit.

10.4 Vlerësimet e mbajtura nga Gjykata Kushtetuese në këtë vendim kanë cenuar parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, duke e kthyer gjykatën në legjislator pozitiv.

11. Subjekti i interesuar Këshilli i Ministrave ka paraqitur parashtrime me shkrim si vijon:

11.1 Gjykata referuese nuk ka parashtruar mjaftueshëm arsye serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës objekt gjykimi, duke pretenduar se cenohet parimi i pavarësisë dhe palëvizshmërisë së gjyqtarit në ushtrimin e detyrës. Si rrjedhim, gjykata referuese nuk legjitimohet në kërkesën e saj.

11.2 Në nenin 147 të Kushtetutës parashi-kohet koncepti i transferimit të gjyqtarit për nevoja të organizimit gjyqësor. Kompetencën për të vendosur për masat disiplinore Kushtetuta ia ka deleguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Lidhur me këtë parashikim Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim me vendimin nr. 21, datë 7.6.2007.

11.3 Në ligjin nr. 9877/2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të miratuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, u reflektua dhe ndryshimi i terminologjisë, nga "transferim" i parashikuar në ligjin e mëparshëm në "dërgim" në rastin e marrjes së masës disiplinore.

11.4 Pretendimi se dispozita cenon parimin e barazisë para ligjit dhe parimin e mosdiskriminimit është i pabazuar. Qëllimi i pushtetit gjyqësor është dhënia e drejtësisë dhe transferimi si masë disiplinore është në interes të administrimit të drejtësisë dhe funksionimit normal të mekanizmave të pushtetit gjyqësor.

12. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka paraqitur shkresë ku sqaron se komentet janë përcjellë nëpërmjet Këshillit të Ministrave.

13. Subjekti i interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka paraqitur parashtrime me shkrim si vijon:

13.1 Ligjvënësi ka qenë i vëmendshëm gjatë hartimit të dispozitës objekt gjykimi kushtetues për të bërë dallimin midis transferimit si lëvizje, kur kërkohet pëlqimi i gjyqtarit, me kalimin në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku ka emërimin. Ligjvënësi për të mos ngatërruar këto raste, përdor fjalën "dërgim" në rastin e lëvizjes si masë disiplinore.

13.2 Në hartimin e dispozitës ligjvënësi ka qenë në koherencë me nenin 138 të Kushtetutës, ku parashikohet se koha e qëndrimit të gjyqtarit në detyrë nuk mund të kufizohet, si dhe paga dhe përfitimet e tjera nuk mund të ulen. Dispozita objekt gjykimi nuk cenon parimet mbi të cilat funksionon pushteti gjyqësor, si pavarësia, karriera gjyqësore, paga dhe përfitime të tjera, për sa kohe ushtron një funksion kushtetues.

13.3 Masa disiplinore e dërgimit të gjyqtarit nga 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel nuk cenon parimet kushtetuese, por gjen zbatim parimi se ligji është i barabartë për të gjithë dhe gjyqësori ka si mision të shërbejë në mënyrë të barabartë për të gjithë.



13.4 Transferimi në kuadrin e një mase disiplinore parashikohet edhe në pikën 3 të paragrafit 3.4 të Kartës Evropiane mbi Statusin e gjyqtarëve.

14. **Subjekti i interesuar, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë**, nuk ka paraqitur parashtrime.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

15. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar se gjykata referuese nuk ka parashtruar mjaftueshëm arsye serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës objekt gjykimi, duke pretenduar se cenohet parimi i pavarësisë dhe palëvizshmërisë së gjyqtarit në ushtrimin e detyrës. Si rrjedhim, gjykata referuese nuk legjitimohet në kërkesën e saj.

16. Gjykata rithekson se kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit kur gjyqtari çmon se ligji (ose dispozita të tij) bie në kundërshtim me Kushtetutën, nuk e zbaton atë, por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e normës. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, i cili përcakton edhe disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrorë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës, *së treti* përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimin nr. 39, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim,

kërkohej një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 39 datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret.

17. Gjykata vlerëson se bazuar në standardet e mësipërme, në rastin konkret gjykata referuese ka identifikuar parimet kushtetuese me të cilat, sipas saj, dispozita bie në kundërshtim me Kushtetutën, ka identifikuar raportin midis vendimit të gjykatës referuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete duke arsyetuar se kjo është dispozita e vetme që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe se nuk ka pasur mundësi të interpretimit të ligjit në pajtim me Kushtetutën dhe se për këtë arsye nuk mund të përdorte mekanizëm tjetër veç atij të paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

18. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet asaj për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të shkronjës “ç”, pika 2, e nenit 33 të ligjit 9877/2008, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar.

B. Për themelën e çështjes lidhur me pretendimin se shkronja “ç”, pika 2, e nenit 33 të ligjit 9877/2008, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, vjen në kundërshtim me nenin 147 të Kushtetutës

19. Gjykata referuese ka pretenduar se masa disiplinore: *“Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij”*, e parashikuar në shkronjën “ç”, pika 2, e nenit 33 të ligjit nr. 9877/2008, *“Për organi-*



zimin e pushtetit gjyqësor” të ndryshuar bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi nuk parashikohet se transferimi është një nga llojet e masave disiplinore.

20. Gjykata vëren se në pikën 4 të nenit 147 të Kushtetutës parashikohet se Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore. Ndërsa në pikën 5 të po këtij nenin parashikohet se *“transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveç kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor”*. Transferimi i gjyqtarit është rregulluar në nenin 21 të ligjit 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Ndërsa në shkronjën “ç”, pika 2, të nenit 33 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet masa disiplinore *“Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij”*.

21. Gjykata ka vlerësuar se konsensusi i gjyqtarit për transferimin e tij është një garanci kushtetuese në funksion të ruajtjes së principit të palëvizshmërisë së gjyqtarit. Garancitë kushtetuese që lidhen me palëvizshmërinë e gjyqtarëve, si dhe me paprekshmërinë e pagës e të përfitimeve të tjera për shkak të funksionit kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur (*shih vendimin nr. 5, datë 16.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata sjell në vëmendje se lidhur me mënyrën e transferimit dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve është shprehur më parë në jurisprudencën e saj. Gjykata vëren se kompetenca për dhënien e masave disiplinore, bazuar në pikën 4 të nenin 147 të Kushtetutës, i është deleguar ligjvënësit të zakonshëm për të parashikuar rastet dhe kriteret e zbatimit konkret të tyre (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në pikën 4 të nenit 147 të Kushtetutës, si një dispozitë referuese, masa disiplinore e dërgimit të gjyqtarit në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel propozohet nga ministri i Drejtësisë, pas inspektimit të kryer, dhe vendimi merret nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

23. Gjykata konstaton se transferimi i gjyqtarit për nevoja të organizimit gjyqësor dhe masa disiplinore e dërgimit të gjyqtarit nga 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij, janë dy

institute të ndryshme. Transferimi sipas kuptimit të nenit 21 të ligjit, për të cilin vendos Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas nevojave të organizimit të pushtetit gjyqësor, nuk është i lidhur me afat kohor të përcaktuar, ndërsa dërgimi i gjyqtarit si masë disiplinore bëhet sipas një afati kohor të përcaktuar nga 1 deri në 2 vjet.

24. Neni 147 i Kushtetutës nuk parashikon asnjë prej masave disiplinore. Në këtë dispozitë me karakter delegates parashikohet se është Këshilli i Lartë i Drejtësisë organi që rregullon transferimin e gjyqtarëve dhe përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit. Sipas kësaj dispozite përgjegjësia disiplinore, llojet e masave disiplinore, rregullohet sipas ligjit të posaçëm, konkretisht ligji nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor” të ndryshuar (*shih vendimin nr. 21, datë 7.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në ligjin e mëparshëm nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përdorej i njëjti term “transferim”, si në rastin kur ndodheshim para transferimit me pëlqimin e gjyqtarit ashtu edhe në rastin kur parashikohej si masë disiplinore ndaj gjyqtarit. Për të bërë dallimin midis dy instituteve, ligjvënësi, në reflektim të vendimit nr. 21, datë 7.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese, me miratimin e ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka përdorur termin “dërgim” në rastin e masës disiplinore. Gjithashtu, në ndryshim nga ligji i mëparshëm koncepti i dërgimit si masë disiplinore ka karakter të përkohshëm, duke përcaktuar afatin nga 1 deri 2 vjet, si një ndër elementet e domosdoshme të tij.

26. Në Kartën Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, si dhe në Kartën Universale të Gjyqtarëve bëhet dallimi midis transferimit kur kërkohet pëlqimi i gjyqtarit dhe marrjes së masës disiplinore. Në Kartën Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve është evidentuar se një gjyqtar që ushtron funksionin në një gjykatë, nuk mundet në parim të caktohet në një tjetër zyrë gjyqësore, madje as nëpërmjet ngritjes në detyrë, pa dhënë lirisht pëlqimin e tij. Përrashtim nga ky rregull lejohet vetëm kur transferimi parashikohet dhe është shprehur si sanksion disiplinor, në rastet e një ndryshimi të ligjshëm të sistemit gjyqësor dhe në rastet e caktimit të përkohshëm të gjyqtarit për të



përforcuar një gjykatë fqinje me kohëzgjatje maksimale të përcaktuar rigorozisht nga ligji, pa cenuar aplikimin e dispozitës së paragrafit 1.4 paragrafin 3.4 i Kartës. Gjithashtu, edhe në nenin 8 të Kartës Universale të Gjyqtarëve parashikohet se transferimi duhet të jetë me pëlqimin e gjyqtarit, përveçse në rastin e masës disiplinore. Masa disiplinore e dërgimit të gjyqtarit në një gjykatë tjetër të të njëjtut nivel me kohë të përcaktuar parashikohet edhe në legjislacionin e disa vendeve të tjera demokratike si Gjermani, Çeki, Slloveni, Poloni, Sllovaki. Në një vështrim krahasues në legjislacionin e këtyre vendeve, parashikohet se transferimi përveçse për nevojat e organizimit të drejtësisë mund të jepet edhe si masë disiplinore kur gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore të tillë që justifikojnë këtë masë.

27. Gjithashtu, sipas gjykatës referuese, dispozita objekt kundërshtimi cenon parimin e mosdiskriminimit dhe parimin e barazisë para ligjit. Sipas saj, qëllimi i ligjit dhe pritshmëria është që gjykatat e të njëjtut nivel të kenë gjyqtarë të të njëjtut nivel në aspektin profesional dhe të integritetit. Individët që veprojnë dhe jetojnë në njësi të ndryshme territoriale kanë të drejtë dhe meritojnë të njëjtin shërbim gjyqësor, si në cilësi, edhe në integritet.

28. Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese se dispozita objekt gjykimi cenon parimin e barazisë para ligjit dhe parimin e mosdiskriminimit, është i pabazuar. Gjykata konstaton se masat disiplinore që merr Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë karakter të përkohshëm, por i shërbejnë funksionimit normal të veprimtarisë së gjykatave, në respektim të parimeve kushtetuese mbi të cilat vepron pushteti gjyqësor, si pavarësia dhe palëvizshmëria në detyrë e gjyqtarit. Si të tilla masat disiplinore kanë qëllim rehabilitimin e gjyqtarit të ndëshkuar (*shih vendimin nr. 21, datë 7.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Masat disiplinore merren ndaj gjyqtarëve pas një procedure kontrolli në respektim të standardeve kushtetuese dhe për shkaqe të përligjura. Qëllimi i tyre është tërheqja e vëmendjes së gjyqtarit në interes të administrimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor për dhënien e drejtësisë, kudo ata ushtrojnë detyrën e tyre, pavarësisht vendit dhe kohës.

29. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se argumentet e paraqitura për shfuqizimin e shkronjës “ç”, pika 2, e nenit 33 të ligjit 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në

Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë të pabazuara. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga Gjykata e Lartë është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a, 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtar kundër: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Gjykatës së Lartë (gjykata referuese) lidhur me antikushtetushmërinë e shkronjës “ç”, pika 2, të nenit 33 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Shumica e ka konsideruar si të pabazuar pretendimin e gjykatës referuese se masa disiplinore: “*Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtut nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij*”, e parashikuar në dispozitën objekt shqyrtimi, bie ndesh me nenin 147 të Kushtetutës.

2. Shumica, bazuar në jurisprudencën e kësaj Gjykate, pasi ka vlerësuar se konsensusi i gjyqtarit për transferimin e tij, i parashikuar në nenin 147/5 të Kushtetutës, është një garanci kushtetuese në funksion të ruajtjes së principit të palëvizshmërisë së gjyqtarit, në mënyrë që ai të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur (*shih paragrafin nr. 21 të vendimit*), ka arritur në përfundimin se transferimi i gjyqtarit për nevoja të organizimit gjyqësor dhe masa disiplinore e dërgimit të gjyqtarit nga 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtut nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij, janë dy



institute të ndryshme. Sipas shumicës, transferimi sipas kuptimit të nenit 21 të ligjit në fjalë, për të cilin vendos Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas nevojave të organizimit të pushtetit gjyqësor, nuk është i lidhur me afat kohor të përcaktuar, ndërsa dërgimi i gjyqtarit si masë disiplinore bëhet sipas një afati kohor të përcaktuar nga 1 deri në 2 vjet (*shih paragrafin nr. 23 të vendimit*).

3. Përpijekjet e shumicës për të argumentuar arsyet e rrëzimit të kërkesës i gjej të sforcuara dhe kontradiktore. Ndryshe nga shumica mendoj se Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e saj.

4. Neni 147/5 i Kushtetutës parashikon: *“Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor”*. Sipas jurisprudencës së Gjykatës (*shih vendimin nr. 21, datë 7.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*), Kushtetuta e ka trajtuar transferimin si një mjet të nevojshëm që mund të përdoret vetëm me pëlqimin e gjyqtarit ose për nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor (për të cilin nuk është e domosdoshme marrja e pëlqimit të tij).

5. Për sa u përket masave disiplinore, sikurse konstaton edhe shumica, neni 147 i Kushtetutës nuk sanksionon asnjë prej masave disiplinore, por në pikën 4 të tij, ngarkon Këshillin e Lartë të Drejtësisë, si organin që vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve sipas ligjit. Në zbatim të kësaj dispozite, neni 42 i ligjit të mëparshëm nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” parashikonte se: *“për shkelje të disiplinës, si dhe për akte e sjellje të tjera diskredituese mund të merret si masë disiplinore edhe transferimi në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të ulët”*. Kjo dispozitë ka qenë objekt kontrolli kushtetutshmërie nga ana e kësaj Gjykate, e cila, me vendimin nr. 21, datë 7.6.2007, ka vendosur shfuqizimin e saj si të papajtueshme me Kushtetutën.

6. Në zbatim të vendimit të lartpërmendur të kësaj Gjykate, ligjvënësi, me miratimin e ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ndër masat disiplinore, në nenin 33/ç ka parashikuar *dërgimin* e gjyqtarit për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku ai ka emërimin e tij.

7. Në ndryshim nga shumica, në mendimin tim, përdorimi i një termi tjetër (“dërgim” në vend të fjalës “transferim”), si dhe përcaktimi i një afati të caktuar (nga 1 deri në 2 vjet), nuk ka ndryshuar thelbin e masës disiplinore. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se me qëndrimet që mban Kushtetuta për transferimin, që, si rregull, kërkon pëlqimin e gjyqtarit, ajo indirekt siguron, jep garanci për pavarësinë e tij. Duke bërë një përjashtim për rastet kur bëhet fjalë për riorganizimin e sistemit gjyqësor, ajo vë në balancë interesat e tij vetjakë me ato publike që lidhen drejtpërsëdrejti me mosfunksionimin e një gjykate konkrete të këtij sistemi (*shih vendimin nr. 21, datë 7.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Nga sa më lart, Kushtetuta parashikon institutin e transferimit të gjyqtarit vetëm nëse ai jep pëlqimin e tij dhe kushtëzon mosdhënien e këtij pëlqimi vetëm për nevojat e organizimit të sistemit gjyqësor. Ndërsa dispozita në fjalë nuk i përmbush këto kritere kushtetuese, sepse përcakton, në thelb, një transferim pa pëlqimin e gjyqtarit.

9. Edhe legjislacionet e vendeve të tjera evropiane (të tilla, si Gjermania, Çekia, Sllovenia, Polonia, Sllovakia), të referuara nga shumica, janë në përputhje me kushtetutat¹² e këtyre vendeve, të cilat parashikojnë në mënyrë eksplicite transferimin si masë disiplinore. Për pasojë, mendoj se krahasimi me ligjet e këtyre vendeve është i pavend në rastin në shqyrtim.

10. Për këto arsye çmoj se shkronja “ç”, pika 2 e nenit 33 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e kundërshtuar, është e papajtueshme me nenin 147/5 të Kushtetutës, prandaj ajo duhej të shfuqizohej.

Anëtar: Vladimir Kristo

¹² Shih nenin 97 të Kushtetutës Gjermane, zbatuar me nenin 30 të ligjit gjerman për pushtetin gjyqësor; nenin 82/2 të Kushtetutës Çeke etj.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 364 lekë